



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI I GJUHËVE, KULTURAVE DHE KOMUNIKIMIT
PROGRAMI STUDIMOR: GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE

INTERTEKSTUALITETI NË VEPRIMTARINË
LETRARE TË FAN NOLIT
(PUNIM DIPLOME PËR MASTER)

MENTORI

Doc. dr. Meral Veseli

KANDIDATI

Leonora Veliu-Fejzullahu

Tetovë, 2021

Deklaratë

Deklaroj se punimin e temës së masterit *“Intertekstualiteti në veprimtarinë letrare të Fan Nolit”* e kam punuar me përkushtim të lartë dhe korrektësi. Duke iu përmbajtur kërkesave të nivelit që ka punimi, deklaroj se jam munduar në aspektin profesional të sjell një trajtim origjinal pa preferenca të të tjerëve, duke sjellur për herë të parë një trajtim të mirëfilltë që i takon veprimtarisë letrare të Nolit. Një gamë e gjerë e krijimtarisë së Nolit më bëri të ndihem fare mirë që t’i qasem me profesionalizëm dhe me kënaqësi kësaj teme, sa tërheqëse po aq të pasur dhe me interes edhe për lexuesin e të gjitha kohërave. Ndhem e privilegjuar që pata fatin të bëhem pjesë e studiuesve të botës noliane, të ndriçoj dhe kontribuoj sado pak në këtë veprimtari. Nga mentorja ime shumë e respektuar pres një vlerësim maksimal për faktin se jam munduar t’i përmbahem parimisht origjinalitetit të shkrimit dhe trajtimit të temës me realizëm, brenda mundësive dhe njohurive që pata edhe shfrytëzimit të literaturës. Kjo jo për faktin se s’ka çfarë të thuhet më shumë për veprën e Nolit, por nivelin e trajtimit, që mund të lëjë hapësirë që do të kërkojë qasje më këmbëngulëse trajtimi në një nivel dhe shkallë të tjera të studimeve. Vështirësitë e shfaqura në kohë pandemie, në sigurimin e literaturës, vlerësoj se kanë mundur të ndikojnë në një masë në pasurimin me burime edhe më të shumta të temës së trajtuar në këtë punim materi. Shpresoj se do ta kem një qasje studimore në të ardhmen edhe më të zgjeruar, për të dhënë ndihmesën time profesionale!

Përmbajtja

Deklaratë.....	2
Përmbajtja.....	3
Abstrakti.....	5
Апстрактен.....	5
Abstract.....	6
Hipotezat.....	7
Qëllimet e hulumtimit.....	7
HYRJE.....	8
Intertekstualiteti në vepër, rëndësia e tij.....	9
Temat dhe burimet e shfrytëzuara nga Noli.....	13
Personalja në poezinë e Nolit.....	15
KAPITULLI I.....	20
1. Lidhja e historisë dhe realja në veprën e Nolit.....	20
1.1. Noli modernist.....	26
1.2. Ngjarjet e mëdha historike që reflektojnë në veprën e Nolit.....	28
1.3. Personazhet biblike dhe reale në veprën e Nolit.....	29
KAPITULLI II.....	30
2. Ndërlidhja e personazheve në veprën e Nolit.....	30
2.2. Reflektimi i jetës shqiptare të kohës në vepër.....	32
2.3. Noli në kulturë dhe në jetën politike.....	35
KAPITULLI III.....	41
3. Rëndësia e veprave të Nolit në kohën bashkëkohore.....	41
3.1. Ndikimi i Nolit modernist në letërsinë e kohës.....	45
3.2. Jeta politike e Nolit dhe reflektimi i saj në vepër.....	48
3.3. Realja e shfaqur në vepër, qëllimet.....	54
KAPITULLI IV.....	57
4. Reflektim i jetës shqiptare.....	57
4.1. Drama jetësore e Nolit, dialog me Biblën.....	60
4.2. Dramaciteti dhe përkimet në veprën <i>Israelitë dhe Filistinë</i>	64
4.3. Frymëzimi real i Nolit në vepër.....	65
5. Dashuria si koncept universal në veprën e Nolit.....	67

PËRFUNDIM	70
Bibliografia	75
LITERATURA	77

Abstrakti

Me qëllim të trajtimit sa më të mirë të kësaj teme masteri, në qendër të studimit do të jetë intertekstualiteti në veprat e Nolit, në poezi dhe në dramën e tij. Noli dëshmohej të jetë njëri nga shkrimtarët poliedrik ndër më të shquarit e modernitetit shqiptar të viteve 30-të, një nga shkrimtarët më të lexuar.

Në poezitë e tij, në masë të madhe, shfrytëzohet materiali biblik. Noli është mjeshtër i fjalës përmes tematikave që zhvillon në vëllimet e tij. Kjo vërehet më së miri te poezitë me temë personale biblike, si te *Moisiu në mal*, *Marshi i Krishtit*, *Krishti me kamxhikun*, *Shën Pjetri në mangall*, *Marshi i kryqësimit*, *Kryqësimi*.

Intertekstualiteti më i thellë vërehet në dramën e tij *“Israelitë e Filistinë*, të cilën e shkroi, më 1902 në Athinë dhe e botoi pesë vite më vonë, në Boston të Amerikës. Fuqia e kësaj drame qëndron në idetë e saj dhe më tepër në pyetjet që shtron autori para lexuesit me *“enigmën”* e tij. Në këtë vepër Noli paraqet idetë që shfaqen edhe në veprat e tjera të më vonshme.

Fjalë kyçe: Poliedriku, intertekstualiteti, drama, poezia personale, tema biblike.

Апстрактен

Со цел најдобро да се реши оваа магистерска тема, фокусот на студијата ќе биде интертекстуалноста во делата, поезијата и драмата на Ноли. Ноли се покажа како еден од најистакнатите полиедрални писатели на албанската модерност од 30-тите години, еден од најчитаните писатели.

Во неговите песни, библискиот материјал се користи многу. Ноли е господар на говорот преку темите што ги развива во своите томови. Ова најдобро се гледа во песните со лични библиски теми, како што се Мојсеј на планина, Маршот Христов, Христос со камшик, Свети Петар на мангалот, Маршот на распетието, Распетието.

Најдлабоката интертекстуалност се гледа во неговата драма „Израелците и Палестина“, која ја напиша во 1902 година во Атина и ја објави пет години подоцна во Бостон, САД. Силата на оваа драма лежи во нејзините идеи и повеќе во прашањата што авторот му ги поставува на читателот со својата „енигма“. Во ова дело на младите, Ноли ги изложува идеите што се појавуваат во другите подоцнежни дела, па дури и се докажува со неговите активности во животот.

Клучни зборови: полиедрална, интертекстуалност, драма, лична поезија, библиски теми.

Abstract

In order to best address this master topic, the focus of the study will be the intertextuality in Noli's works, poetry and drama. Noli proves to be one of the most prominent polyhedral writers of Albanian modernity of the 1930s, one of the most read writers.

In his poems, biblical material is used extensively. Noli is a master of speech through the themes he develops in his volumes. This is best seen in poems with personal biblical themes, such as: *Moisiunëmal (Moses on the mountain)*, *MarshiiKrishtit (The March of Christ)*, *Krishti me kamxhikun (Christ with the whip)*, *ShënPjetrinëmangall (St. Peter on the brazier)*, *Marshiikryqësimit (The March of the Crucifixion)*, *Kryqësimi (The Crucifixion)*.

The deepest intertextuality is seen in his play "*Israelitëe Filistinë*" (*Israelis and Palestinians*), which he wrote in 1902 in Athens and published five years later in Boston, USA. The power of this drama lies in its ideas and more in the questions that the author asks the reader with his "*enigma*". In this work of youth Noli lays out the ideas that emerge in other later works, and is even proven by his activities in life.

Keywords: Polyhedral, intertextuality, drama, personal poetry, biblical themes.

Hipotezat

Hipoteza kryesore: Realiteti shqiptar në intertekstualitetin e veprës së Nolit me temë nga Bibla.

Hipotezë speciale: Përkimet e shfaqjes tekstuale në veprën e Nolit me theks të veçantë lirinë e vendit, të Shqipërisë.

Qëllimi specifik: Krahasimet me ngjyrimet dhe mjeshtërinë artistike të Nolit duke nxjerrë paralele me ngjajshmëritë me shqetësimet kolektive shqiptare të kohës.

Treguesit e hulumtimit: Qasja studimore për të ndriçuar ide, qëllime dhe mjeshtëri të Nolit krijues, analiza e trajtimit të temave aktuale të shqetësimeve personale dhe kolektive të kohës mëtohet ta përmbush në plotëni sjelljen e ideve të avansuara të intelektualit të përmasave botërore, të Nolit tonë. Shpalosja e trazimeve personale dhe kthimi mjeshtëror i tyre te kolektiviteti, që ka meritat dhe përgjegjësitë e krijimit meritator të një shqetësimi djaloshtar dhe atdhetar tek autori. Kjo ide lëvrohet me fuqi të lartë poetike te poezia personale dhe te drama.

Qëllimet e hulumtimit

Qëllim bazë i këtij punim masteri është një kontribut më shumë në temën e shpeshtë të përdorur nga Noli, të intertekstualitetit në poezinë dhe dramën e tij.

Nga ata që pak e njohin veprën e Nolit mund t'i mveshin epitete të shumta të një vepre me ngjyrimet fetare, por sapa të lexohet ajo me vëmendje, del qartë në të realiteti i dramës shqiptare i mveshur me ngjyrim të botës fetare biblike, i këtij realiteti i cili nuk bartë vetëm shqetësimet personale të autorit, por të mbarë shoqërisë shqiptare të kohës. Kjo është mjeshtëria poetike e Nolit tonë e cila mbarështrrohet qartë dhe se rrallë herë mund ta hasësh te shkrimtarët tjerë të kohës. Një temë e tillë e trajtuar jo shpesh nga studiues dhe kritikë letrar, do të nxjerrë në dritë pikëpamje të ndryshme të Nolit të cilat rrisin interesimin e gjithë atyre që duan ta njohin edhe më mirë dhe më thellë krijimtarinë letrare të tij.

HYRJE

Të shkruash për temën *eIntertekstualitetit në veprën e Nolit*, vlerësohet të jetë një nismë e përmasave të mëdha intelektuale dhe profesionale, që mëton të ndihmojë me një kontribut modest në fushën studimore për të dhënë një vepër domethënëse në këtë temë voluminoze. Ndonëse me veprën e Nolit deri më sot janë marrë autorë të shumtë, në fokus të trajtimit të këtillë mendohet se nuk njihet ndonjë autor, andaj hudhja e një vështrimi përmbajtësor, lë për të dëshiruar për një arsye përmbajtësore një qasje të tillë. Kjo për faktin se të gjithë studiuesit e derisotshëm e trajtuan veprën e Nolit në këndvështrime të ndryshme, duke dhënë një ndihmesë përmbajtësore dhe duke e ngritur atë në majat më të larta të vlerësimeve kritike dhe duke e radhitur shkrimtarin ndër autorët më eminent të modernitetit shqiptar. Jo rastësisht ndodh një gjë e tillë sepse Noli me veprën e tij dha një kontribut të lartë duke i dhënë letërsisë moderne shqipe vepra të cilat u lexuan dhe u vlerësuan lart nga lexuesit dhe studiuesit e çdo kohe.

Fan Noli sjell në letrat shqipe një stil individual, të tijin. Ai solli në letërsinë shqipe poezinë politike, në kuptimin e madh e të mirëfilltë të fjalës. Si poet e njëkohësisht personazh legjendar i saj, ai krijoi një vepër madhështoresi rrallëkush në letrat evropiane. Duke qenë edhe në poste të larta të organizimit politik të Shqipërisë së kohës, në vendin më të prapambetur të Evropës, Noli e këndoi fatin e tij të zymtë pa sentimentalizëm që perkon me heronjete e veprave të antikitetit greko-iliriane. Ai nuk shkruante kujtime si shumë shkrimtarë të kohës si burrështetas që ishte. Nuk bën moral, por ka disa fantazi krijuese që e trazojnë vazhdimisht. Noli, si duket, u tregua paksa i butë me trajtimin e temave të së keqes, duke bërë herë-herë Krishtin të dukej me kamxhik si shoqërim me bindjet fetare që kishte dhe për të nxjerrë një paralele mes trajtimeve ideale të tij për të arritur deri tek bindjamë e lehtë e tjetrit.

Nga letërsia e përbotshme moderniteti shqiptar jo vetëm që huazoi forma të ndryshme të shprehjes letrare, por rivitalizoi edhe struktura gjuhësore të llojeve të tjera të ligjërimit. *Modernia krijoi një tip të ritit të folurit i cili nuk ndërlihet me asnjërin prej ligjërimeve stilistike. Andaj me të drejtë mund të konstatohet se si shembull të risemantizimit të ligjërimeve të tjera në funksion gjithnjë të strukturimit të ri artistik të jetës, mund të merret krijimtaria letrare e Nolit, i cili me materialin e vjetër ndërton vepra të reja.* (Krasniqi, Kode të ligjërimit letrar, 1988) Kjo gjë më së miri vërehet tek poezia "*Marshi i Krishtit*" të e cila kemi figura mitologjike dhe strukturat e

gjuhës së teksteve fetare të cilat Noli tjetëron, i transformon mjeshtërisht dhe me to ndërtoi një vepër tërësisht të radhe origjinale. Një paralele mund të nxirret edhe te Bodleri, i cili simbolet e katolicizmit ia referoi së dashurës dhe vetvetes. Ngjashëm veproi edhe Noli i cili simbolikën biblike e lidh me përvojën e tij personale nga Revolucioni i Qershorit. Krijimtaria e tij poetike nuk mund të shpjegohet përmes tërësisë së komplekseve të ndryshme poetike, por përmes tërësisë së komplekseve të ndryshme stilistike që e përbëjnë stilin modernist të korpusit poetik. Andaj, *“pohimi se poezia e Nolit me simbole mitologjike, që është edhe pikëpamje mbizotëruese në pjesën më të madhe të studimeve shqiptare e ndryshon dukshëm simbolikën realiste me që frymëzimin nuk ia jep feja, as substanca e mitologjisë, por realiteti konkret historik shqiptar që ndërlihet me të dhe ua ndryshon simboleve mitologjike funksionin ideologjik.”* Pjesa dërmuese e krijimtarisë së Nolit vlerësohet se është e përfshirë me simbolika të shumta. Trajtimet intertekstuale hetohen thellësisht sa për të mundur të hetohen pothuajse në çdo pjesë të saj.

Intertekstualiteti në veprën e Nolit, thënë thjeshtë e vë ligjërimin biblik gjithnjë në funksion të trajtimit të realitetit aktual historik, që ka të bëjë me njërën prej veçorive të modernes. Kështu Noli e pasuroi letërsinë shqipe me strukturë të refigurative dhe ritmike. Kultura e tij kritike dhe mendja e tij kërkuese, që plotësonte të kultivohej në studime të përhershme dhe në mësim gjuhësh, ishin dhunti e karakterit të personalitetit të Nolit. Ai u desh mua një stilist e gojëtar i shquar i shqipes. Ka një dallim fare të vogël në mes të teksteve të fjalimeve të tij prej teksteve të shkruara, qofshin ato me argumente politike, shoqërore apo letrare. Mënyra e thurjes së tekstit, argumentimi është i një niveli të lartë në tekstet e folura dhe në tekstet e shkruara. Një stil i tillë i Nolit u bë model shkrimi edhe për shkrimtarët e rinj.

Sistemi retorik i bindjes i përshkon edhe hartimet poetike, që përmbledhin përvojën e tij jetësore. Këto poezi, të shkruara sipas rastit dhe të lidhura me ngjarjet personale e shoqërore, reflektojnë suksesshëm deri në majat e suksesit poetik të Nolit gjatë gjithë krijimtarisë së tij poetike.

Intertekstualiteti në vepër, rëndësia e tij

Nga studiuesit shihet si pambarim kufiri i intertekstualitetit. Në çdo tekst ka intertekstualitet si artikulum shumë i qartë që shton vlerat kuptimore të veprës së vënë në qendër të studimit. Ballafaqimi me mundësitë dhe mungesat e intertekstualitetit zhvillohet brenda një konteksti të caktuar, në temën që zhvillohet brenda një konteksti të caktuar, në temën që lidhet me funksionin intertekstual të veprës së Nolit.

Intertekstualiteti është lëvizje nëpërmjet së cilës një tekst përshkruan një tekst tjetër dhe interteksti tërësinë e teksteve drejt çka një vepër bën shenjë, qoftë duke iu referuar në mungesë apo në prani. Ai është një kategori e përgjithshme e cila përfshinë forma të ndryshme si parodi, rishkrim...*Ky përkufizim përfshin kështu marrëdhënie të cilat mund t'i japin vend një forme të saktë-citimi, parodia, alizioni...-apo një pikëtakimi të përpiktë dhe fare të vogël, apo dhe një lidhje të dobët të parandjerë ndërmjet dy teksteve, lidhje së cilës është e vështirë t'i jepet një formë. Në këtë këndvështrim, intertekstualiteti dërgon tek imitimi dhe ndryshimi i përjetshëm i traditës nga autorët e nga veprat që e rimarrin atë.*(Piegay-Gros, Hyrje në intertekstualitet, 2011)

Studiuesit pajtohen se intertekstualiteti në kuptimin e sotëm, si dije e metodë, si teori e praktikë analitike, buron nga fundi i viteve 60-të të shekullit të shkuar nga shkrimet e Julia Kristevës(Kristeva, 1960)e cila në qasjen e saj i referohet Bekhetin-it.

Në studime të shumta për letërsinë, intertekstualja, si metodë dhe si pikëshkrim i interpretimit të tekstit, vetvlerësohet të ketë zhvilluar praktikën e vet, si dhe nocionet e trajtimeve e praktikës përkatëse. Praktikrat e trajtimit të intertekstualitetit sot janë të krahasueshme. Për më tepër, praktikrat krijuese intertekstuale, qoftë edhe të praktikave gojore, janë të vjetra me mija vjet dhe hyrja në studimin e tyre do të kërkonte ndihmë nga antropologjia. Dëshmitë e studimeve të tilla datojnë nga koha e Platonit e këndeje, ndërsa e shekullit tonë është vetëm teoria e intertekstualitetit. Kjo jo rrallë vërehet edhe në poezinë dhe dramën e Nolit,që trajtohet gjerësisht në këtë punim masteri. Kur thuhet kështu del se tekstet janë të pranishme brenda teksteve në nivele të ndryshme, në forma më pak apo më shumë të njohura.

I pajisur me një kulturë të gjerë, të mbledhur si për çudi në rrethana tepër të rënda e kundërshtuese, në një jetë plot turbullira politike, Noli ishte njohës i mirë i shumë gjuhëve dhe kulturave të përbotshme.Një senzibilizëm artistik, që mban brenda një dhuratë tepër të çmueshme për lexuesit, me të cilën do të shoqërohen gjatë gjithë jetës së tyre.

Nga vepra e tij kanë mundësi të marrin modele shkrimtarët e rinj, artistët, gazetarët, dramaturgët, historianët dhe kritikët e kompozitorët sepse Noli solli më shumë se një shembull për t'u marrë model krijimi. Gjithë këto dhurata, gjithë ky veprim i tij, për dyzet e ca vite rresht, ishte në një shërbim të vetëm, në shërbim të Shqipërisë, të idealit shqiptar. Ishte një ideal shoqëror–kombëtar, gjithnjë shoqëror dhe kombëtar. Nga e gjithë kjo mund të thuhet me plot bindje se Noli është shkrimtari dhe kritiku i parë shqiptar i cili solli në shkrimet e tij, veçanërisht në parathëniet e librave të tij, pikëpamjet shoqërore dhe kombëtare të tij. Për të dëshmuar një konstatim të tillë vlen të lexohen disa prej tyre me vëmendje të shtuar.

Jo një herë u tha se me intertekstualitetin u morën autorë të shumtë, siç është edhe Linda Hutchion, një përfaqësuese e mendimit letrar e kulturor amerikan e cila intertekstualen e shtron në një rrafsh paksa më të gjerë dhe kulturologjik. Ajo intertekstin e historisë dhe të fikcionit i sheh me një status paralel në tekst. Për dallim nga orientimi esencial brendatekstori i filozofisë së teorisë evropiane intertekstuale, ajo intertekstit i qaset më tepër nga thjerrëza e lidhjes së tij me historinë. Është e mjaftueshme që kjo qasje të përshkohet edhe nga Noli në veprat e tij, në dramë dhe poezi. Kjo për faktin e thënë më lart se ngjarjet e mëdha historike nëpër të cilat po kalonte Shqipëria, reflektojnë fuqishëm në tërë krijimtarinë e Nolit.

Interteksti është një jehonë e teksteve të hershme, të njohura, brenda një teksti të ri. Është e bollshme të besohet dhe hetohet kjo gjë në shumë nga poezitë me temë biblike që nuk i ka të pakta Noli, në dramën “*Israelitë dhe Filistinë*”.

Intertekstualiteti duhet të ketë identitetin e vetqë i atribohet vlerave letrare me kritikën e burimeve duke insistuar më shumë në theksimin e interpretimit se sa në vendosjen e fakteve të veçanta të kompozicionit të tekstit letrar. Për të rrumbullakësuar këtë vështrim në aspektin historik të konceptit të autorë të ndryshëm, bëhet trajtimi real i ruajtjes së fuqisë e i rikontekstualitetit të teksteve. (Piegay-Gros, Hyrje në intertekstualitet, 2011) Pra, tekstet nxirren nga kontekstet paraprake dhe i ndërkal në kontekstin e ri. Konteksti i një teksti letrar është ai që e afirmon natyrën e letërsisë dhe e verifikon atë në mënyrën e vet. Në një mënyrë, ndërrimi i këtyllë i kontekstit d.m.th. ndërrim i tekstit. Konteksti i jashtëm është një tip tjetër i kontekstit, që ka natyrë sociokulturore dhe që mund të jetë pjesë e kontekstit letrar.

Vetë nocioni i intertekstualitetit, nënkupton praktika të ndryshme shkrimi të shtresuara në tekst, të unifikuara tematikisht dhe semantikisht brenda një njësie tekstore. Nuk është dhe aq e vështirë që këto praktika të hulumtohen, sipas interesimeve, deri në gjenezën e tyre zanore e

diskursive, nganjëherë edhe autoriale, por duke mos e kurthuar kështu në kritikën e burimeve dhe në atë filologjike, pavarësisht nevojave të rastit.

Citimi shfaqet me të drejtë si forma emblematike e intertekstualitetit: *ai bën të dukshme përfshirjen e një teksti në një tekst tjetër. Kodet shtypshkrimore-citimi i nxjerr mënjandë, përdorim shkronja korsive apo thonjzash... e vënë në jetë këtë heterogjenitet.*(Piegay-Gros, Hyrje në intertekstualitet, 2011)

Sido që të jetë citimi, qoftë i thjeshtë apo i lartë, bie lehtë në sy në një tekst, pa kërkuar nga lexuesinjë vëmendje të shtuar. Hetimi i tij kuptohet por vëmendje ndaj tij duhet shtuar veçanërisht në interpretimin tekstor që i bëhet atij ... *“zgjedhja e tekstit të cituar, caqet e prerjes së tij, mënyrat e ngjitjes, kuptimi që merr ky citim nga përfshirja në kontekst të ri... të gjitha këto janë po aq elemente thelbësore ndaj domethënies së tij,*(Piegay-Gros, Hyrje në intertekstualitet, 2011)*që mund të kenë peshë kuptimore edhe nga besueshmëria dhe autoriteti, po pat dilema shpërfillëse në tekst. Citimi mund të shërbejë edhe si përforsim i ndiesisë që është duke u diskutuar, me qëllim të bindjes së lexuesit për çështje kuptimore, duke pasuruar pjesën ku montohet ai. Citimi është i lidhur me motivimin që shprehja dhe veprimi i të shprehurit janë të lidhura, qoftë edhe si shprehje metaforike si në prozë dhe në poezi, pa e dalluar tekstin e shprehur.*

Një formë tjetër e ndërtimit të intertekstualitetit në një vepër të shkruar është edhe referenca. Vetë tema që trajton autori është një referencë bindëse e cila të shpie te ndërlidhja e mendimeve që dëshiron ta bëjë autori me gjithë brendinë tekstore, duke mos u mjaftuar vetëm me shpjegimin nga trillimet dhe realiteti i shfaqur nga narratori dhe autori.

Element tjetër që ndërlidhet me intertekstualitetin është vjedhja e një teksti me qëllim të fshehjes së realitetit intertekstual, duke mos u vënë si citim i dukshëm. Autori provon ta kalojë një citim, duke e përvetësuar, me ose pa qëllim, si krijim të vetin. *Të vjedhësh një vepër, kjo është pra të thërrasësh një pasazh, pa treguar që nuk jemi autori. Në fakt ajo përbën një cënim të pronës letrare, një lloj mashtrimi i cili vë në shkak jo vetëm ndershmërinë vjedhësit, por edhe rregullat e funksionimit të cilat qeverisin qarkullimin e teksteve*”(Piegay-Gros, Hyrje në intertekstualitet, 2011), duke u nënkuptuar lehtë nga mungesa e lidhjes funksionale mes pjesës së vjedhur dhe mendimit të autorit për çështjet të cilat i trajton në vepër.

Si shprehje intertekstuale mund të mirret edhe aluzioni, duke mos u marrur si shprehje jo e fshehur, por as e hapur. Ai shprehet në mënyrë më të thelluar në tekst. Me të autori dëshiron të

bëjë lidhjen e gjërave të thëna në tekst me gjërat e pathëna, me qëllim të sforcimit të efekteve që i dëshiron para lexuesit nëpërmjet ngjarjeve historike, mitologjike etj. duke kërkuar vëmendjen e lexuesit. *Aluzioni letrar nënkupton në fakt që lexuesi do ta kuptojë me fjalë të zbuluara atë çka autori dëshiron t'ia thotë pa ia thënë hapur.* (Piegay-Gros, Hyrje në intertekstualitet, 2011) me qëllim që mos të ndalet në hollësira të cilat mundën ta rëndojnë dhe dëmtojnë tekstin letrar.

Qëllimi i studimit në këtë punim masteri mëton që filozofinë e strukturës dhe të lojës intertekstuale të tekstit, të mos e gozhdohet për shtratin e burimeve të kritikës, prej ku natyrisht vilen të dhëna të rëndësishme, por të sillen shembuj konkret të ilustrimeve tekstore dhe ndërlidhjet autoriale që bën Noli në veprat e tij, për faktin se do të paraqitet jo një herë.

Pavarësisht prej bindjeve që kanë studiuesit e ndryshëm se teksti nuk ka vetëmjaftueshmëri, mund të thuhet me bindjen më të plotë se teksti ka vetidentitet. Kur flitet për praninë e nivelit intertekstual të një teksti, gjithsesi se ka vend të mendohet edhe për moduset e paraqitjeve të estetikave të ndryshme, të asaj që quhet estetikë autoriale ose individuale.

Në raste të caktuara, shtresat dhe format që bashkëveprojnë në intertekst, siç e kemi edhe në veprën e Nolit, dallohen me ndonjë shënjim teknik, si ndonjë tipar identifikues. Në të vërtetë, intertekstualiteti, si aktivitet i gjerë në esencë është tekst kulturor.

Temat dhe burimet e shfrytëzuara nga Noli

Vetë jeta e Nolit ishte një dramë e vërtetë. Ai që nga fëmijëria pati ecejake aspak të lehta, sa nga kushtet e vështira sociale, por edhe politike. Fati i tij është një gërshetim i fateve të vendit të tij, Shqipërisë. E gjithë jeta e tij shfaqet më së miri në veprën “*Autobiografia*” të cilën Noli e shkroi në vetën e tretë me synimin e shkrimit sa më objektiv të saj. Vepra e tij është më e fuqishme si tekst letrar pikërisht me pjesën ku përshkruhet fëmijëria e tij, që ka shumë elemente domethënëse që paraqiten si rregull në një vepër autobiografike. Autobiografia si e tillë mund të kuptohet si bazë e veprave të tjera të Nolit. Në anën tjetër, duke qenë vepra jetësore e autorit për vetveten e shkruar në moshë të pjekur, kur është në përfundim të veprës jetësore të tij. Në këtë tekst janë disa njësi autobiografike që krijojnë mitin e autorit.

Noli disa herë na jep te kuptojmë me shembuj konkret me veprën e tij se kishte pasion muzikën dhe heronjte që e frymëzonin nga fëmijëria e hershme e tij. Veprimet e heronjve të mëdhenj ishin nxitje reale për ngritjen e tij në shumë drejtime.

Trajtimi i temës *Intertekstualiteti në veprën e Nolit* jo sezë vend edhe vepra “*Autobiografia*”, por po i lëhet hapësirë për të dëshmuar se intertekstualiteti në veprën e tij nuk është i rastësishëm, që do të trajtohet më shumë në dramën e tij “*Israelitë dhe Filistinë*” dhe te poezitë me temë biblike, ku shihet më qartë ndikimi fëmijëror i autorit, por që e lëvroi këtë temë në mënyrë mjeshtërore. Andaj në moshë të shtyer Noli do t’i vlerësojë heronjtë e tij të fëmijërisë duke na dhënë një vepër autobiografike të shkruar në vetën e tretë dhe duke i dhënë peshë bukur të lartë sa të bëhet mjaft e pëlqyer nga lexuesit dhe e vlerësuar lart. Heronjtë që i mori shembull Noli ju dha hapësirë të çmueshme duke proklamuar barazi për të gjithë me idenë e shfaqjes së mendimit të lirë. Napoleonin e çmonte për ndryshimet revolucionare të bëra në Evropën e kohës, për kalimin nga shoqëria e ndarë feudale kah shoqëritë me qarkullim të lirë. Heroin kombëtar Gjergj Kastrioti-Skënderbeun e çmonte si organizator dhe prijës të rezistencës shqiptare kundër të huajve me qëllim të krijimit të kultit të lirisë tek populli shqiptar dhe kulturës autentike shqiptare. Ky i fundit është identik me veprimet e vet Nolit i cili nuk do të pushojë së vepruari deri në fund të jetës, për një Shqipëri ndryshe nga ajo që ishte nën pushtimin otoman.

Në valën e këtyre identifikimeve, me heronjtë në të ri dhe moshë të shtyer të tij, Noli e përkufizon vetveten me kuptimin e çiftit *heroizëm/sakrificë* ose *Skënderbe/Krisht*. Në lidhje me këtë skemë karakterizuese janë vlerësuar veprimet e tij shoqërore dhe veprat e tij shkrimore duke nxënë fill pikërisht nga “*Autobiografia*”.

Me një qëndrim jo të gjatë në Shqipëri, që kurorizohet dhe rrënohet me ngritjen në pushtet, në pozitën e kryeministrit të Shqipërisë për gjashtë muaj (1924), kultura e tij kryengritëse rritet gjithnjë e më shumë sa qëndroi në diasporën shqiptare (Egjypt, Evropë dhe Amerikë) dhe se ka në vete një shkallë jo të zakonshme. Kjo kundërvënie e kryengritje gjithnjë mbetet në udhën ndërmjet predikuesit e vepruesit të prijësit shpirtëror-prift e prijës politik-kryeministër. Kjo tregon se Noli edhe pse lucid dhe me një mendje kritike, nuk është liruar fare nga modelet ideale të veprimit, madje as atëherë kur dështimet e veta politike i vlerëson si gjeste të vlerës historike për kohën kur jetoi dhe veproi.

Në kulturën shqiptare Noli mbetet edhe si shqipëruar mjaft i talentuar sepse kryeveprat e letërsisë botërore i bëri të flasin shqip ku deri më sot nuk doli asnjë autor t’i përkthejë të njejtat përsëri, siç ndodh jo rrallë herë, që një vepër e ndonjë autori të përkthehet disa herë nga autorë të ndryshëm. Nëse kemi parasysh që drama e tij “*Israelitë dhe Filistinë*”(1907) është vepër e rinisë, të gjitha veprat letrare të pjekurisë janë bërë pas shqipërimeve dhe pas përfundimit të

veprimtarisë së tij të bujshme politike, që dëshmon një rikthim të krijimtarisë letrare ngjashëm siç e kishte filluar.

Personalja në poezinë e Nolit

Në botën shqiptare Noli pati një paraqitje të shkëlqyeshme si poet. Ai ishte poet i një inspirimi të ri, që krijoi poezinë dinamike, të metaforave të forta, ku do të provohet të paraqitet shumë më shumë gjatë analizave më të hollësishme në vijim të punimit, sepse pikërisht poezia mendohet se ka premisa teorike intertekstuale se pjesa tjetër e krijimtarisë së Nolit. Edhe drama e Nolit ka një ngjyrim shumë të përafërt me këtë temë. Jo vetëm personazhet e përfshirë nëtë, por vetë ngjarjet e trajtuara në të e dëshmojnë faktin se Noli nuk iu shmang temës intertekstuale gjatë gjithë krijimtarisë letrare të tij.

Poezia e Nolit, po u analizua më në hollësi, del të jetë më shumë poezi politike-patriotike. Kjo për faktin se autori në tërë krijimtarinë e tij poetike, u ndikua kryekëput nga rrethanat aktuale politike nëpër të cilat po kalonte Shqipëria e kohës. I ndodhur mes udhëkryqesh dhe dilemash të shumta, Noli nuk hamendësoi, ai zgjodhi rrugën nëpër të cilën, siç u tha jo një herë, heronjtë e tij të ëndërruar dhe shumë të respektuar ishin Krishti, Napoleon Bonaparta dhe Gjergj Kastrioti-Skënderbeu. Poezia e tij i takon zhanrit satirik, veçanërisht ajo me temë biblike, por që dominon poezia me temë patriotike. Të temës satirike janë poezitë “*Bismilah tridhjet saneja*”, “*Marshi i Barabajt*”, “*Kënga e monarkisë*”, “*Thomsoni dhe kuçedra*”, “*Elegji për Luigj Gorakuqin*”, “*Shpell e Dragobisë*”, “*Shën Pjetri në mangall*”, “*Moisiu në Mal*” dhe poezitë me të cilat arriti majat e lartësimit të vlerave të mirëfillta poetike dhe vlerësimin më të lartë të vjershërimit, poezitë “*Hymni i Flamurit*” dhe “*Jepni për Nënë*” që janë vjersha politike-patriotike dhe me dy lirika intime, poezinë “*Plak topalldhe ashik*”: dhe “*Sofokliu*”.

Në një bisedë me shkrimtarët e rinj në SHBA, në fillim të viteve 60-të, Fan Noli deklaroi: “*Përpikuni të shkruani për ato që i keni provuar vetë në jetë. Ç’është e vërteta, librat më mirë që janë shkruar deri më sot janë pak a shumë librat autobiografikë. Shkruani autobiografinë tuaj, por pa fshehur asgjë. Pranoni mëkatet tuaja. Sa për poezitë e mia, unë nuk merakosësja shumë për to. Mendoja se ato nuk vlenin fare. Më vonë lexova poezitë, mendova se meritonin të botoheshin*” (Hamiti, Letërsia moderne shqiptare, 1999).

Në një bisedë tjetër të ngjashme të vitit 1958, Noli përgjigjet: “Po të pyesni cilën poezi do ta parapëlqejë, poezinë e *Marathonomakut*, si më të mirën”(Hamiti, Letërsia moderne shqiptare, 1999). Këto mendime të Nolit për krijimin letrar dhe veprat e tij poetike, të thëna në moshën e madhe të tij, në moshën kur njeriut s’i bëjnë përshtypje as lavdet as kritikrat, kanë një vlerë vetëm për cilësimin e poetit për veprat e veta dhe për lexuesit dhe komentuesit e veprave të tij.

Një rëndësi të veçantë për poezinë ka dhe mendimi i Nolit për lidhjen e poezisë me jetën e autorit, pra me autobiografinë. Mandej konstatimi se arti nuk duhet t’i fshehë mëkatet personale, siç u tha edhe më lart, që mund të jetë një hyrje e sigurtë në interpretimin e poezisë së tij. Rëndësi ka e dhëna se Noli nuk kishte kujdes për poezinë e tij, por interesimin atij ia shtoi shkrimtaridhe interpretuesi, njohësi më i mirë i veprave të tij Mitrush Kuteli.

Rëndon, poezitë e Nolit kanë në brendi një ngjarje, një ndodhi. Ato nuk shfaqen në trajtë të lirikës intime duke paraqitur ngjarje në variante të ndryshme. Çdo poezi komunikon ose më mirë të themi dialogon me një poezi ose mendonjë kontekst tjetër dhe këto ndërveprime bëhen më të theksuara kur komentohen ose analizohen personazhet që janë pjesë e këtij ndërveprimi. Toni luftarak, tragjik, humori apo satira që i përshkon, në të vërtetë lidhen me qëndrimin e autorit për fenomenin për të cilin shkruante shpesh në poezitë e tij, pa zgjedhur motivin e veçantë. Kjo gjë, jo rrallë dilte edhe në tekste poezish me temë dedikimi, që ia shtoi madhështinë gjithë krijimtarisë poetike të Nolit duke e bërë atë shembull frymëzimi për shkrimtarët dhe artistët e kohës edhe më vonë.

Në gjithë krijimtarinë e tij mund të gjenden plot figura stilistike me të cilat Noli ua shton fuqinë shprehëse më të plotë. Një figurshmëri të tillë mund të vërehet në dy poezitë e tij të njohura, siç janë: “*Marshi i Krishtit*” dhe “*Marshi i Barabajt*”.

Te “*Marshi i Barabajt*” është një satirë shumë e fortë politike me të cilën poeti, me një urrejtje të papërmbajtur godet Ahmet Zogun dhe klikën e tij kundërshtarë.

Ashtu siç i zgjedh epitetet më pozitive në portretin e Krishtit, d.m.th. vetvetes, po kështu zgjedh epitetet më negative për portretin e Barabajt, që sipas gojëdhënës kishte qenë një kriminel, nën figurën e të cilit nënkupton vetë Ahmet Zogun:

Tradhëtor, ti na nxive, na le pa atdhe,
Ti na çthure, na shkule, na çduke çdo fe,
Varfëri, poshtërsi, robëri ti na dhe,

Derbeder, ujk e derr: Hosanna, Barabba!

O stërnip i Kainit, tepdil si bari,

Ti na shtryp e na shtryth e ti gjakun na pi,

Ti na ther e na grin e për qef na bën fli;

O kokuth e lubi: Hosanna, Barabba!(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

(Marshi i Barabajt)

Poezinë e Nolit e shquan vargu ritmik e i rimuar me tetë, dhjetë e dymbëdhjetë rrokësh. Kjo poezi ka kumbim të jashtëzakonshëm, madje, shpesh me ritmin e marshit. *Të rralla janë poezitë e këtilla satirike në letërsinë shqipe ku fizionomia e një tirani reaksionar të jetë damkosur e njetosur në këtë mënyrë.*(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988) Është fjala për ekzemplarën e egoistit, hipokritit, gënjeshtarit, dinakut dhe përgjithësisht njeriut të poshtër, që për interesat vetiake, kalon çdo kufi dhe shkelë çdo njeri.

Gjithnjë në këtë frymë dhe në formë alegorike është shkruar edhe satira “*Marshi i kryqësimit*” e cila trajton luftën politike që iu bë Nolit dhe përkrahësve të tij pas dështimit të Revolucionit të Qershorit. Edhe këtu, si edhe te vjershat tjera me motiv biblik, portreti i Krishtit del përmes fjalëve që thotë turma e mashtruar nga demagogët:

Do të vrasim,

Jisu, se të kemi baba,

Do të varrim, Mesi, se të kemi Usta,

Se s’ke dashur as jetë as martes’ as para:

Kryqëzoje, Pilat, në Kalvar, Golgotha.(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

(Marshi i kryqësimit)

Nga këto vargje kuptojmë se viktima që duhet të kryqëzohet është idealisti, mbase dëshironte të jetë mbinjeri, andaj zgjodhi këtë rrugë e cila nuk i solli dobi veç vuajtjeve, nuk i mundësoi të krijonte familje, të shijonte idilën e lumturisë familjare. Ai zgjodhi të identifikohet me një profet, andaj përdori figurën biblike. Këto figura na jepen në mënyrë shumë të hapur në tekst. Çdo lexues që ka kulturë leximi nuk do të qëndronte indiferent ndaj këtyre figurave dhe më

pas do të konstatontese Krishti është po ai që e njohim nga historitë fetare biblike. Noli zgjodhi një figurë të tillë me qëllim të identifikimit dhe të afrisë më të theksuar me njerëzit e rëndomtë, për të ndikuar më lehtë në ta, që t'i arrinte më lehtë qëllimet e tij në jetën e përditshme:

* * *

Varreni, posa s' do as të vras' as të varrë
As të bënjë të keqen as gjakun ta marrë,
Dhe katilët me nam na i qan si të marrë:
Kryqëzoje, Pilat, në Kalvar, Golgotha.

Vrajeni kryengritësin e Shënjtëruar
Si katil të mallkuar, atë ka kërkuar,
Se kujtoj që pa armë ka për të na zgjuar:
Kryqëzoje, Pilat, në Kalvar, Golgotha.(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

Vargu i tretë i strofës së fundit të vjershës “*Marshi i kryqësimit*” dëshmon për ndryshimin e botëkuptimit të Nolit pas dështimit të Revolucionit të Qershorit. Ai e kuptoi, megjithëse me vonesë, se përdorimi i armëve dhe i forcës dhe i dhunës do ta kishte ruajtur qeverinë e tij demokratike.

Pas ngjarjeve të hidhura të vitit 1924, Noli i mërguar, do t'i kujtojë ditët më të stuhishme të jetës së vet dhe bashkë me këto do t'i kujtojë miqtë, shokët dhe bashkudhëtarët e asaj kohe. Poezia e tij do të jetë një këndvështrim i anëve të ndryshme të atij revolucionit.

Me vjershën “*Marshi i kryqësimit*”, është e ngjashme edhe vjersha tjetër e vogël “*Kryqësimi*” sepse edhe ajo e thekson luftën që iu bë Nolit, për ta etiketuar armik të popullit pas ngadhënjimit të forcave kundërshtarë politike në Shqipëri. Edhe këtu, si në vjershën e mëparshme, poeti e paraqet veten në fytyrën e Krishtit, të cilin armiqtë e kryqëzojnë dhe e gozhdojnë:

Po troket çekani
Po kërcet mejdani,
Dor' e këmbë i çpon,
Krishtin kryqëson.

Me tërbim goditin
Me gjënim e ngjitin
Turma ulërin
Nëna blegërin.

Çdo peron plagë
Përvëlton si flagë
Çurka gjak buron
Fryhet dhe pikon.

Kryqet ngulen, shtisen,
Tallen, qesëndisen;
Sipër kryqe tre,
Tri Mari për-dhe. (Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)
(*Kryqësimi*)

Vjersha ngërthen në vete gjitha ndjekjet dhe persekutimet, shantazhet dhe likuidimet që iu bënë jo vetëm Nolit por të gjithë krerëve që ishin të një mendje me të dhe që i mbetën besnik idealeve të Revolucionit të Qershorit. Gjithë të tillëve Noli do t'ua njohë meritat dhe përmes poezisë së tij, do t'i bëjë të pavdekshëm, mirëpo në anën tjetër, poeti s' do t'i harrojë edhe çastet më të vështira, kur u braktis prej disa të tjerëve me të cilët kishte bashkëpunuar deri dje. Kjo notë e largimit të papritur të njerëzve të idealit shfaqet edhe në vjershat tjera të Nolit.

Këto poezi paraqesin ide zotëruese që mbështetet në një personazh, dhe pastaj kthehet në personazhe të njohura, si Moisiu, Krishti, Kirenari, Barabaj, Shën Pjetri, lumenjtë e Babilonisë; ose greke: Marathonomaku; ose figurat e mentalitetit lindor: Sulltani, Salep-Sulltani, Sulltani e Kabineti; ose të rrethit jetësor: Luigj Gurakuqi dhe Bajram Curri.

Me zhvillimet e mëtejshme, për pasojë, të figurave konceptuale, si dhe të një qëndrimi të përhershëm autorial për fenomenet e shfaqura në poezi, rendi i dytë i figurave jep përcaktimin interpretues nolian: Kryeprofet, Mesi, Kryetrim, Trim-tribun, Liberator, Baba, me shenjë vlerësuese pozitive, apo të adhurimit. Në anën tjetër dalin figurat vlerësuese negative, a të përjashtimit, si: *Salep-Sulltani, Tradhëtor, Baraba, Laro, Lubi, Dallkauk, Kopuk, Derbeder* etj.

Këto figura të kontrastit madje i japin tonin poezisë që mbështetet ose në urim ose në mallkim.

Intertekstualiteti në veprën e Nolit, lidhet më shumë me figurat e dashura nga fëmijëra e tij, me të cilën identifikohet atëherë në imagjinatën e vet krijuese, kurse pas vitit 1924, kur u shkruan këto vjersha edhe me përvojën personale të autorit.

KAPITULLI I

1.Lidhja e historisë dhe realja në veprën e Nolit

Fan S. Noli sot vlerësohet të jetë një nga figurat më markante të letërsisë dhe kulturës shqiptare. Kjo gjë jo një herë u tha për të sepse la gjurmë të pashlyeshme duke dhënë kontribut mjeshtërisht dhe duke u bërë shembull i gjithë krijimtarisë letrare shqipe edhe për gjenerata të tëra. Gjenialiteti krijues i Nolit e bën atë të jetë aktual me veprat e tij në çdo kohë. Sa aktuale, sa reale, vepra e Nolit edhe sot mbetet e vlerësuar nga lexuesit. Noli ishte një mjeshtër i lartë dhe që njihte artin letrar në përmasa të mëdha. Fan Noli e këndoi fatin e tij pa kurrfarë zbulurimi, me një notë të lartë që ngjanin sikur vinin drejt nga kohërat e lashtësisë antike. Noli në veprën e tij nuk bën

moral, por ka disa fantazi krijuese që e trazojnë vazhdimisht. Noli, si duket, u tregua paksa i butë me trajtimin e temave të së keqes, për të nxjerrë një paralele mes trajtimeve ideale të tij për të arritur deri te bindjamë e lehtë e tjetrit.

Noli krijoi një tip të ri të të folurit i cili nuk ndërlidhet me asnjërin prej ligjërimeve stilistike të autorëve të tjerë të kohës së tij. Andaj me të drejtë mund të konstatohet se si shembull të ligjërimeve të tjera në funksion gjithnjë të strukturimit të ri artistik të jetës mund të merret krijimtaria letrare e Nolit, i cili me materialin e vjetër ndërton vepra të reja. Kjo gjë më së miri vërehet në shumë nga krijimet e tij artistike, tek poezitë me motiv bilik dhe të tjerat me plot figura mitologjike, ku kemi strukturat e gjuhës së teksteve fetare. Noli i tjetëron, i shkrinë aty mjeshtërisht dhe i transformon me shumë sukses dhe me to ndërton një vepër tërësisht të re dhe origjinale e cila bëhet shembull.

Kjo gjë jo pa u hetuar vërehet edhe në vjershën më të dashur të tij, *Rent, or Marathonomak* në të lidhet me mesazhin e saj që ka dhe e bën të jetë shumë më ndryshe nga poezitë e tjera dhe më të fuqishme në shprehjen ideoartistike të saj.

Kishin kaluar pesë vjet nga këto ngjarje kur Noli po shpresonte se përsëri populli do të ngritej në këmbë për ta përmbysur tiraninë zogiste. I entuziazmuar nga këto ngjarje të gëzueshme, në prill dhe maj të vitit 1930, kohë kur ishte në Hamburg të Gjermanisë, Noli shkroi dy poezitë emblematike për të, poezinë “*Anës lumenjve*” dhe “*Rent, or Marathonomak*”, që dëshmojnë më së miri për përpjekjet çlirimtare të Nolit për idetë progresive përparimtare për vendin e tij. Shpresa e fitores së popullit mbi regjimin shtypës të udhëhequr nga Zogu, përbën thelbin e poezisë *Rent, or Marathonomak*, ndryshe nga poezitë tjera të tij, për të cilat shpesh shfrytëzoi figura të sajuara alegorike. Kur grekët fituan kundër persianëve, një ushtar-lajmëtar, vazhdon pa pushuar fare për dyzet kilometra, kumton lajmin e fitores, por nga rendja e lodhja plandoset i vdekur për tokë duke arritur të shqiptojë vetëm një fjalë të vetme, fjalën kumt “*fituam*”! Marathonomaku del si njeri, që të gjitha energjitë e tij, mendjen dhe zemrën e tij ia ka kushtuar fitores. As vështirësitë e tij, as vuajtjet, nuk ia ndalin turrin e vrapin për t’ia dhënë bashkëkombasve të tij lajmin e shumëpritur:

Rent, or rent, rent e thuaj

Se u ç’thur ordi e huaj,

Se betejën e fituam
Dhe qytetin e shpëtuam!
Rent, or rent,
Rent, or Marathonimak.

(Rent, or Marathonomak!)(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

Dëshira për ta përhapur lajmin e fitores popullit të tij, protagonistin e bën edhe më të fortë,
më këmbëngulës e qëllimor, të arrijë në cak:

Kap një degë prej dafine
Dhe vërtitesh ndaj Athine,
Nëpër fush' e brek mi brek
Këmba tokën as t'a prek,

Hip e zbrit,

Petrit, Marathonomak!

Ke një plagë, po s'e the,
Djers' e gjak pikon për-dhe;
Do që ti të jesh i pari,
Për triumfin lajmëtari
Flamur-gjak,

Kuqo, Marathonomak!(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

Noli ka dhënë parafytyrimin e lajmtarit të fitores së popullit mbi shtypësit dhe tiranët, duke krijuar raporte interteksti. Vjersha përfundon me një optimizëm ngadhënjyes të autorit duke ngjallur shpresë personale se në çdo çast mund të kthehej në vendin e tij, në pushtetin e përmbysur padrejtësisht nga Ahmet Zogu dhe të tjerët:

* * *

Rent kudo, duke bërtitur,

Nëpër shekuj faqe-ndritur

Se i vogli shkel viganin

Dhe i shtypuri tiranin,

Veç e tok,

Tok, or Marathonomak!(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

Marathonomaku është trajtuar me mjeshtëri të rrallë si ide e vetëmohimit dhe sakrificës. Ai vdes për t'u bërë i pavdekshëm. Dhimbja e tij kthehet në adhurim dhe respekt të lartë.

Ideologjia mbi shndërrimet shoqërore e ndeshjes së të voglit me viganin, e të shtypurit me tiranin, do të bëhet boshti qendror edhe poezia “*Anës lumenjve*”, sipoezia më e fuqishme e Nolit. Në këtë poezi bëhet një sintezë poetike e kërkimeve të tij ideore dhe pikëpamjeve politike. Me këtë poezi paraqitet në masë të madhe autobiografia e tij në nivelin e një ndieshmërie e cila ngrihet në dramë shpirtërore të poetit. Poezia, e shkruar në variantin e parë mbante titullin “*Anës lumenjve të Babillonisë*” dhe ngritej mbi tekstin e Psallmit 136 të Davidit ku këndohet mbi dhembjen që ka i arratisuri për vendin e vet. Poezia është shkruar me një renditje të dramatizuar të pamjeve, ideve, emocioneve: gjendje e figuruar e vendit, emërtimi i shtresimeve që shkretëruan vendin, përshkrim i gjendjes shpirtërore të autorit, thirrje për zgjim dhe për ndërrimin e situatës, shpesh për ndërrime përfundimtare dhe kthimi përfundimtar i autorit shpirtërlënduar në atdheun e tij. Këtu Noli flet edhe në vetën e tretë sepse tronditja e tij emocionale shfaqet që në fillim, në mes dhe në fund të këngës, duke kaluar nëpër tri shkallë të shndërrimit, nga dëshpërimi i pafund kah shpresa. Ky fenomen i Nolit del shpesh me formulën poetike me këtë radhitje:

a) *Po vajtonj pa funt, pa shpresë,*

b) *Ëndërronj pa funt, pa shpresë*

c) *Brohorit me bes' e shpresë.*

Drama e Nolit shfaqet e theksuar nëpërmjet ëndrrës dhe brohoritjes nga pashpresa në shpresë. Deri sa poeti i mërguar vajton anës së lumenjve evropianë: Elba, Spres, Rinit e Tunës, ai përjeton zjarminë kolektive në gjeografinë shqiptare që e shënjojnë lumenjtë: Vjosa dhe Buna, Semani dhe Drini.

Vjersha paraqet idetë e larta të Nolit që përkojnë me një ide shtresash të ndryshme shoqërore. Në idenë e tij Noli ilustron teoritë e ndryshme sociale në veprën e tij. Kjo gjë shfaqet më së miri me paraqitjen e varianteve të ndryshme të hapësirës gjeografike në veprën e tij. Në variantin e parë ishte:

Katundar' e punëtorë,

Që nga Moska gjer në Vlorë!

kurse në variantin e dytë del:

Katundar' e punëtorë,

Që nga Shkodra gjer në Vlorë!

Në rastin e parë kishte një shprehje të theksuar ideologjike, në rastin e dytë është një rrudhje, një përkufizim etnik. Në një gjendje të këtillë shpirtërore Noli kaloi edhe në zhanre të tjera të krijimit, për të kuptuar se tashmë veç ishte pajtuar me realitetin e shndërruar me zhvillimet në vendin e tij.

Në pjesën e parë të poezisë “*Anës lumenjve*” Noli ishte i lodhur nga dëshira dhe mundi që jepte për atdheun e tij, Shqipërinë. Ai vijonte të brengosej së tepërmi nga gjendja e tij shpirtërore, përshkruan gjendjen e tij të rënduar emocionale duke shprehur shqetësimin e tij të madh që ka për fatet e kombit, gjendjes së tij nën sundimin e feudalëve, që synonin të gllabëronin gjithçka si dhe shtypësve dhe shfrytëzuesve të huaj:

Ku e lam' e ku na mbeti

Vaj-vatani e mjer-mileti

Anës detit i palarë,

Anës dritës i paparë,

Pranë sofrës i pangrënë,

Pranë dijes i panxënë,

Lakuriq dhe i dregosur,

Trup e shpirt i sakatosur?(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

Fati tragjik i vendit e nxjerr poetin në dëshpërim të madh. Fatkeqësinë e bashkëkombasve të tij, autori e lidh edhe me fatkeqësinë e tij personale. I ndodhur larg atdheut, në mërgim, i zhgënjyer dhe i demoralizuar së tepërmi, gjithnjë para ndonjë atentati të njejtë me të Luigj Gurakuqit, që ia kishte marrë jetën, Noli ndiqte me shqetësim çdo zhvillim që ndodhte në Shqipëri.

Nga dëshira e madhe që kishte për ta ndryshuar këtë gjendje dhe për ta flakur një herë e përgjithmonë sundimin çifligaro-borgjez, Nolit i dukej se po dëgjonte zërin e një kushtrimi, që i ngjallte optimizëm dhe i shtonte shpresë të madhe për ndryshim. Ai ka dëshirë të jetë ashtu, që populli të ngritet, të mos qëndrojë i shtypur, por të krijojë raporte me kontekstin politik të vendit, duke pretenduar se zëri kryengritës do të depërtojë në katër anët e vendit:

Dhe një zë vëngon nga lumi,

Më buçet, më zgjon nga gjumi,

Se mileti po gatitet,

Se tirani lebetitet,

Se pëlçet, kërcet furtona,

Fryhet Vjosa, derdhet Buna,

Skuqet Semani dhe Drini,

Dridhet beu dhe zengjini
Se pas vdekjes ndriti jeta,
Dhe kudo gjëmon trumpeta:
Ngrehuni dhe bjeruni,
Korni dhe shtypni,
Katundar' dhe punëtorë,

Që nga Shkodra gjer në Vlorë!(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

1.1. Noli modernist

Të flasësh sot për Fan S. Nolin pa pasur një përvojë të mirëfilltë krijuese është një mangësi e madhe sepse nuk mund të cilësohesh njohës i mirë i krijimtarisë letrare të shkrimtarit modernist, të shkrimtarit i cili la gjurmë të pashlyeshme në kulturën shqiptare.

Kur thuhet se vepra letrare është ajo që e shquan karakterin dhe rëndësinë ideoartistike që ka për t'i dhënë pastaj vlerësimet meritore që ka edhe shkrimtari i saj, vlen më së shumti për figurën e Nolit i cili jo rastësisht radhitet ndër shkrimtarët më të spikatur të modernitetit shqiptar.

Fan Noli për një arsye edhe më të madhe fitoi vlerësime të tilla me faktin se ishte nismëtar i filleve të para të modernitetit në kulturën shqiptare, bashkë me Faik Konicën.

Vjershat që i shkroi Noli dhe shqipërimet e bëra të veprave më të mëdha të letërsisë botërore që i la trashëgim kulturës sonë, përfaqësojnë në kuptimin e tyre simbolik një rëndësi kuptimplote shumë domethënëse.

Kontributi i Nolit është voluminoz, pikërisht me shqipërimin e tragjediave të njohura të Shekspirit, ku shfaqen më së miri përpjekjet e tij për lirinë e vendit.

Noli shqipëroi disa drama të Ibsenit, romanin “*Don Kishoti i Mançes*” të Servantesit, “*Rubairat*” e Omar Khajamit, disa vjersha të Edgar Alen Poes, të Sharl Bodlerit e disa të tjera.

Nga njohës të veprës së Nolit del dhe konstatimi se pikërisht nga kjo njohje që pati Noli, nxu shkas të shkruajë edhe veprën monumentale të kulturës shqiptare “*Historinë e Skënderbeut*”.

Në brendinë e tërësishme të kësaj vepre, në krijimet e veta të shqipërimeve, ndërlidhet veprimtaria më komplekse e modernitetit shqiptar të paraqitur nga Fan Noli. Autori në to bëri një jetësim të fuqishëm duke ndërlidhur shpesh herë realitetin shqiptar të kohës dhe duke na lënë të kuptojmë se këto shqipërime të gjasonin me krijimet origjinale të Nolit. Ai ka jetuar në to, në figurat e heronjve. Noli në veprat e tilla shfaqet me shpirtin e çiltër krijues. Del i tillë si te përshkrimi i Brutit dhe Hamletit, si te Omar Khajami ashtu edhe te Don Kishoti, te “*Prometheu lidhur*” dhe te “*Armiku i popullit*”, që ishte në të vërtetë miku i tij i vërtetë.

Për formimin e tij krijues dhe shprehjet gjuhësore të shprehura në to, ka një qëndrueshmëri të theksuar në literaturën shqiptare. Noli nuk është shkrimtar i përmasave eterike, por është shkrimtar i plisit të dheut, siç cilësohej jo një herë. Ai ka shumëçka origjinale në krijimet e tij dhe shprehjet ideoartistike. Noli aspak nuk i gjasonte një luleje e cila çelë një ditë dhe të nesërmen mund ta shohësh të vyshkur. Nga studiuesit përshkruhet si një lis i vjetërme shumë gjethe dhe rrënjë të thella në tokën mëmë. E këtillë është edhe gjuha e veprës së tij. Në këtë nuk ndihet ëmbëlsira e qartë kur dihet se ai pati një jetë aspak të lehtë.

Noli jo rrallë me shqipërimet e tij shfaq fuqinë kritike të interpretimeve letrare të kryeveprave të letërsisë botërore. Introdiktat e tij në këto vepra hapin një dialog ndërmjet kultures së huaj dhe kultures shqiptare.

Noli thekson vazhdimisht rëndësinë e ideve përparimtare në zhvillimin e shoqërisë, çmon lart rolin e letërsisë në kuadrin historik dhe ndikimin që ushtron ajo kur niset nga realiteti, lidh jetën e autorit me veprën, bën aktualizimin e veprës në funksion të shoqërisë. Kështu te parathënia e romanit Don Kishoti i Servantesit, qëllimet e Don Kishotit dhe të Sanço Panços, autori shpjegon mënyrën se si dëshirojnë protagonistët t’i arrijnë qëllimet e tyre, tregon gjendjen e tyre klasore dhe botëkuptimet kontradiktore që kanë.

Në këtë pjesë studimi Noli karakterizimin e bën përmes kontrastesh. Rëndësia e veprës zbulohet drejtë, duke u lidhur me kushtet konkrete, gjysmë feudale dhe gjysmë borgjeze të vendit tonë në kohën kur Noli shqipëroi veprën.

Për ta paraqitur në mënyrë më të detajuar pikëpamjen e tij në vepër, Noli paraqet në mënyrë të detajuar dhe kritike, me të cilën zbulon botën e brendshme të tij emocionale për t’u hakmarrë, ngjashëm si Hamleti i cili kishte përgatitur plane të hollësishme që të hakmirrej për vrasjen e babait të tij. Te Hamleti Noli shkruan:

Detyra e Princit Hamletit është e çkoqur: Pas zakonis medieval, ka detyrë t'ia marrë gjakun t'atit, të vrarë me të pabesë; pas nderit, ka detyrë t'a çkëputë t'ëmën nga krahet e atij që i vrau të shoqin e parë; pas kanunit të shtetit, si princ trashëgimtar dhe si mbret legjitim i Danimarkës... Arsyeya kryesore e vajtjeve të Hamletit duhet kërkuar më tepër në ndjenjën e që ka pësuar një tronditje fatale për vdekje se sa në ndjenjën që është i pazot për punë e veprim. Për të kuptuar mirë sjelljen e tij, duhet të kemi përpara një të sëmur me ethe, i cili është ngritur me pahir nga shtrati për të mbaruar një detyrë të shenjtë, i cili, gjysmë në ëndërr, i këputur dhe me shpirtin në dhëmbë, përpiket me qip dhe me thonj të ngritet zvarrë përpjetë në majën e bregut, para se të rrëyohet përdhe pa frymë. S'është as i gjallë as i vdekur, as i zgjuar as i fjetur tamam: ndodhet buzë vdekjes, buzë greminës, ku e di që shpejtë a vonë do të përmbysset e do të copëtohet. Mendja e tij banon në banesat midis fantazmave, skeleteve dhe kafkave grimacante. Që të mos marroset, e të mos vras veten, e të mos pëlcasë nga e keqja, duhet të koncentronjë tërë vullnetin dhe energjin' e tij, duhet ta frymësonjë kufomën e tij me gjallësi, duhet ta çponjë pa pushuar me yzengji të përgjakura, kalin e tij të ngordhur për një sulm sipërnjerëzor.(Shekspir, 1981) Një disponim i tillë vërehet gati në shumicën e veprave të tij.

1.2. Ngjarjet e mëdha historike që reflektojnë në veprën e Nolit

Dimë se Fan S. Noli gjithë ngritjen më të madhe të tij fillimisht e pati duke qenë i lidhur me ngjarje të rëndësishme historike, siç ishin zhvillimet dramatike në Shqipërinë e kohës, në përpëlitjet e vlimeve politike që ndodhnin në vendin tonë pas daljes nga sundimi shekullor osman dhe ndikimet dramatike të zhvillimeve të shumta të ndikuara nga fuqitë e mëdha, të shteteve fqinje të cilat jetësisht ishin të interesuara për një destabilitet të shtetit shqiptar.

Për të gjykuar drejt rreth kësaj çështje, duhet me domos të mendohet drejt dhe të njihen gjithë ato ngjarje për të cilat është thënë jo pak herë deri më tani se reflektojnë edhe në zhvillimet e ndryshme politike, kulturore, arsimore etj, që lëjnë gjurmë të pashlyeshme edhe te shkrimtarët e kohës, në mesin e të cilëve është edhe Noli ynë.

Reflektim shumë i qartë mbi këtë çështje s'do mend se pasqyrojnë edhe letërkëmbimet e autorit të cilat janë vlerësuar si shumë të rëndësishme. Noli në to pasqyroi bindjen, qëndrimin

dhe përgatitjen e tij intelektuale sepse pati kontakte me shtresën më të avancuar intelektuale të kohës të cilën e përcolli denjësisht deri në fund të veprimtarisë së tij krijuese dhe politike.

Kontaktet që pati në veçanti me Ismail Qemalin, Luigj Gurakuqin, Asdrenin, Hil Mosin e në veçanti me Faik Konicën, nga i cili thuhet se e mësoi mirë e mirë edhe gjuhën shqipe, Noli me përgatitjen e tij ruan një vlerë të jashtëzakonshme njohëse të pikëpamjeve dhe qëndrimeve për ngjarjet historike në të cilat mori pjesë aktive. Kjo dëshmohet më së miri për disa çaste shumë të veçanta historike kombëtare duke ruajtur vlerat letrare e kombëtare.

Mund të veçohen disa etapa shumë të veçanta të zhvillimeve të kohës, p.sh. Ato të dhjetëvjetëshit të fundit të Rilindjes Kombëtare, apo pjesës së parë të viteve 20 të shek.XX. Gjatë viteve 30-të e shohim një tërheqje të dukshme të Nolit nga jeta politike, e shohim shtimin e aktivitetit kulturor e letrar, duke pasur në fokus edhe shqipërimet.

Në këto fille të veprimtarisë së vet politiko-shoqërore, Noli ende nuk është shkëputur nga disa ide dhe bindje idealiste, si p.sh. ideja e kultit të njeriut të “fortë” ide kjo që i erdhi nga filozofi Fridrih Niçe. Noli nuk jetonte pranë realitetit shqiptar të kohës dhe se nuk e kishte të lehtë ta kuptonte.

Zhvillimi i ngjarjeve të mëdha historike, përparimi i lëvizjes së gjerë popullore kundër sundimit shekullor turk dhe sulmeve grabitqare të fqinjve, bën që Noli të fitonte shumë si politikan dhe t’i kapërcente disa nga pengesat kryesore që pati.

1.3. Personazhet biblike dhe reale në veprën e Nolit

Në dramën *Israelitë dhe Filistinë* duken përpjekjet e autorit për të krijuar karaktere të ndryshme. Figurë qendrore e dramës është Samsoni me një fuqi trupore fantastike, që ka marrë përsipër t’u mbush mendjen filistinëve që edhe ata të bëhen monoteistë si israelitët. Samsoni ishte njeri prej mishit e prej gjakut si të gjithë njerëzit tjerë. Personazh tjetër i rëndësishëm në dramë është Rabini, njeri i zgjuar dhe i matur në gjykime. Ai është i pari që e kupton dredhinë e filistinëve të cilët shquheshin për dredhi, kur këta dërguan disa njerëz te ata, në mesin e tyre, të filistinëve,

kishin edhe Dalilën. Figura e tij personifikon njeriun me përvojë të madhe që vështirë mund të mashtrohet nga të tjerët. Rabini nuk ka iluzione dhe kundërshton ashpër shkuarjen e Samsonit vetë filistinët sepse e dinte se edhe mëparë kanë shkuar shumë të tjerë por që s'janë kthyer. Personazh tjetër i rëndësishëm në këtë dramë është Dalila. Ajo është e vetëdijshme për ndikimin e bukurisë së saj, prandaj e thotë pa e fshehura ishte në bashkëbisedim me Samsonin. Kur është fjala për atdheun, ajo e braktisë Samsonin duke i flijuar ndjenjat intime që kishte. Ajo pranon pa hezitim kërkesën e mbretit, që me lajka dhe ledhatime ta mashtrojë Samsonin që ta kishin më të lehtë filistinët ta mposhtnin atë.

Midis figurave të tjera është edhe Rahila, e fejuara e Samsonit, e cila edhe pse kupton për tundimet e të dashurit të saj, shpreh bujarinë duke iu gjetur për ndihmë atij në çastet më të vështira kur ai i kishte të prera fuqitë nga filistinët dhe s'mund të vepronte fare.

Si dramat tjera të kësaj periudhe që kemi, edhe drama *Israelitë dhe Filistinë* dëshmon për një fazë të re të zhvillimit të dramaturgjisë shqiptare e cila ishte fare pak e njohur në letërsinë tonë shqipe, apo thënë thjeshtë e pa lëvruar fare.

Drama nuk shquhet për dialogje të theksuar dhe të shkathta. Atë e rëndojnë disa mendime të errëta e të papërcaktuara. Gjuha e saj është një toskërishte e thjeshtë dhe jo sa kërkohet të jetë e kristalizuar. Ajo përmban trajta të gabuara dhe një varg fjalës të gjuhëve të huaja të pakuptueshme për lexuesin, të cilat lehtësisht kanë mundur të zëvendësohen me fjalë shqipe. As nga to e as nga motivi biblik që e përshkon tërë krijimtarinë e tij letrare Noli nuk do të lirohet deri në fund të veprimtarisë krijuese. Edhe në vepra tjera poetike të Nolit hasim personazhe, sa reale sa të imagjinuar dhe të sferës biblike, që më të shpeshtë janë te poezia. Në përkimet e tyre që hasim, në veçanti nga sfera biblike, studiuesit ndajnë mendimin se gjithçka është e kuptueshme të jetë mbështetur në veprat biblike pasi ai mbi dyzet vjet shërbeu si prift.

KAPITULLI II

2. Ndërlidhja e personazheve në veprën e Nolit

Trajtimi i temës së intertekstualitetit në veprën e Nolit është pasqyrë e qartë e kontributit për ndriçimin sa më kuptimplotë në fushën studimore dhe të radhitjes pozitive të shkrimeve përmbajtësore për veprimtarinë e Nolit në kulturën shqiptare në tërësi.

Në fund të veprës së tij “*Autobiografia*”, të botuar më 1958, Fan S. Noli e vlerëson punën e tij kulturore në mënyrë përmbledhëse, në formimin e veprimit kishtar-atdhetar, pavarësimin të Kishës Ortodokse shqiptare nga ajo greke; ndihma dhe kontributi i tij në pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, më 1920; në fushën e veprimit kombëtar-politik--revolucionar, udhëheqja e Revolucionit Demokratik të Qershorit, më 1924; në fushën e publicistikës, drejtimi i gazetës *Dielli* e fletoreve të tjera letrare në Amerikë.

Gjithë ky opus i veprimtarisë së përgjithshme të Nolit është një tregues i mjaftueshëm për të trajtuar një temë mjaftë interesante në këtë punim masteri që, s’do mend, sjell një kënaqësi dhe privilegj të lartë, sepse trajtohet vepra e një poliedristi i cili u vlerësua gjithnjë nga studiues dhe kritikë në fushën e letrave shqipe, sa herë u kërkua dhe u bë temë trajtimi nga ta.

Kontributi i Nolit reflekton një lidhje të fuqishme me zhvillimet kulturore të shek. XX, sepse ai i shërbeu kësaj kulture me përkujdesin dhe përkushtimin më të lartë të mundshëm si poet, dramaturg, historian, biograf, publicist, orator e mbi të gjitha si shqipëruar i rrallë. Noli e pa Shqipërinë si një idealist dhe atë u përpoq praktikisht ta ndryshojë si politikan me një kontribut të pashoq dhe me përpjekje titanike. Noli ishte shkrimtar dhe veprimtar udhëheqës duke pasur ndikim të ndërsjellë tek njëra dhe veprimtaria tjetër e tij.

Fan S. Noli u rrit në frymën atdhetare, ndonëse fare pak jetoi në ambientin shqiptar. Kjo gjë reflektoi dukshëm edhe në gjithë veprimtarinë e tij krijuese. Ai gjithmonë do ta mbajë veten se kishte këtë prejardhje sepse edhe banorët e fshatit të tij nuk dinin gjuhë tjetër pos gjuhën shqipe.

Trajtimi i intertekstualitetit në veprimtarinë e Nolit mëton të japë shembuj konkret se paraqitja e tij nuk ishte e pamenduar, por ishte mjeshtërore dhe me shumë kuptim. Një gjë e tillë vlerësohet se do t’u ndihmojë edhe lexuesve të ardhshëm që mirren me veprën e Nolit në mënyrë qëllimore. Interteksti jo një herë u shfaq te autorë të ndryshëm në letërsinë e përbotshme, çka jep për të kuptuar se Noli e gjeti të gatshme lëvrimin e kësaj teme dhe solli freski në kulturën shqiptare. Me veprën e tij Noli ndikoi dukshëm në përforcimin e vetëdijes kombëtare duke trajtuar tema nga historia e kombit tonë dhe duke i freskuar ato vepra me burime bindëse për lexuesin. Disa herë, jo veç nga njohës të veprës së tij, është thënë se tek mjeshtëria e shfaqur në krijimet letrare të Nolit vërehet një përvojë e lartë. Jo rastësisht është konstatuar se vlerësuesi më i denjë i një vepre letrare është koha, andaj me të drejtë mund të konstatohet edhe këtu se ky vlerësim mund t’i dedikohet edhe krijimtarisë brilante të Fan Nolit.

Fillimisht u vlerësua si më e udhës të trajtohet dykuptimësia në poezinë e Nolit gjatë punimit të kësaj teme masteri, për t'u ndalur pastaj te vepra “*Historia e Skënderbeut*”. Trajtimi dykuptimor u trajtua edhe në dramën e tij “*Israelitë dhe Filistinë*” duke sjellur në formë tekstore momentet kyçe të rolit të protagonistëve si referencë bindëse për lexuesin.

Noli në moshën 20-vjeçare shkroi veprën e tij të parë, dramën “*Israelitë dhe Filistinë*”, ku trajtoi dhe ballafaqoi idetë e kulturave të ndryshme në popuj të ndryshëm.

Ndonëse në vëllim është e mangët, poezia e tij zë një vend të rëndësishëm në letrat shqipe. Këto poezi të shkruara, sipas rastit të lidhura me ngjarjet shoqërore e personale të poetit, janë shprehje autobiografike. Poezia e tij është njëherësh politike dhe qëllimore. Madje me idetë, me figurat themelore, me mënyrën e shprehjes, vjershat e tij hyjnë në sistemin e mendimit të tij kritik e ideologjik.

Shumë autorë janë marrë me veprën e Nolit por i pari që u muar me të ishte Mitrush Kuteli, i cili më 1948 bën përmbledhjen poetike *Albumi nga federate Vatanë Amerikë*.

2.2. Reflektimi i jetës shqiptare të kohës në vepër

Gati gjysma e poezive të Nolit i përkasin vjershave me motiv biblik, si “*Marshi i Krishtit*”, “*Krishti me kamxhik*”, “*Marshim i barabajt*” etj. të cilat edhe pse të hartuara në bazë të këtyre motiveve, nuk përshkohen nga fryma teologjike.

Figurat dhe motivet e huajtura nga librat fetarë janë vetëm si shkas poetik që shërbejnë si mjet për të shprehur pikëpamje të ndryshme në aspektin politik të autorit. Më parë mund të thuhet se kanë karakter autobiografik dhe janë të lidhura ngusht me mendimet dhe konceptet e vetë poetit i cili atë kohë ishte në vorbullën e ngjarjeve dhe ndërlikimeve shoqërore e politike.

Në këto vjersha trajtohen ngjarje të ndryshme politike në Shqipëri para, gjatë dhe pas Revolucionit të Qershorit të udhëhequr nga vetë Noli. Poeti e paraqet veten si udhëheqës të lëvizjes sonë demokratike, që duke luftuar tiraninë dhe shfrytëzimin e thellë që i bëhej popullit, mundohet dhe flijohet për të varfërit.

Jo një herë u tha se Noli intertekstualitetin e trajtoi në mënyrë mjeshtërore në çdo vepër të tij. Kjo gjë shfaq pikëpamjet realiste dhe domethënëse që ka autori me qëllimin e ndikimit sa më të fuqishëm në vepër dhe tek lexuesi dhe për të nxjerrë paralele më kuptimplote mes veprës dhe

lexuesit. Noli nuk e bëri këtë për të na dhënë një pasqyrim të pikëpamjeve të tij fetare, por më shumë shfaq idetë atdhetare duke sjellur me këto vepra tablo nga realiteti shqiptar i kohës.

Noli ishte adhurues i muzikës dhe i heronjëve kryesorë të ngjarjeve kombëtare dhe botërore. Sa ishte fëmij, në moshë të hershme, autori kishte rast të ndikohej nga një kulturë që e kishte të kultivuar edhe familja e tij. Noli shpesh herë veprimet e heronjve të mëdhenj, siç ishte Krishti për të frymëzuesi në çdo kohë, ishin nxitësit kryesorë për t'u ndikuar fuqishëm në orientimet e tij të më vonshme dhe për të shkuar drejtë sukseseve në të gjitha fushat e krijimtarisë politike. Se kishin ndikim në jetën e tij figurat e mëdha historike dhe biblike e shohim pastaj më vonë kur veten e identifikonte me Napoleonin. Më pas Noli nuk pushoi së përzgjedhuri edhe figurat tona kombëtare, siç ishte hero i tij i preferuar me të cilin identifikohet lehtë, të Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, për të cilin e shkroi edhe një vepër, që cilësohet të jetë vepra më e arrirë në historinë, kulturën dhe traditën shqiptare të kohës pas historisë së Barletit.

Noli temën e intertekstualitetit e bën trajtim dhe reflektim me qëllim të ndikimit sa më të theksuar duke i dhënë hapësirë reale me qëllim të ngritjes së vetëdijes të lexuesit. Kjo mund të kuptohet si hapësirë për të dëshmuar se intertekstualiteti në veprën e tij nuk është i rastësishëm. Noli që lëvrues mjesh tëror i kësaj teme në të cilën shfaq hapur, por edhe vlerësohet lart se praktikoi një mënyrë mjesh tërore. *Noli figurën e Krishtit e çmonte si figurën më tërëndësishme në historinë e mbarë. Noli atë e shihte si përkrahës të vegjëlisë dhe shprehjes së mendimit të lirë, që provoi ta proklamonte gjatë gjithë jetës së tij.* (Bala, F.S. Noli - Poet, (Vështrim studimor), 1988)Figurën e Napoleon Bonapartës e vlerësonte si figurë që solli ndryshimet pozitive në tërë Evropën e kohës dhe se vendosi njërend të ri botëror. Ai ishte i pari që kishte proklamuar për kalimin nga shoqëria e ndarë feudale kah shoqëritë me qarkullim të lirë në ide dhe zhvillimet pozitive.

Heroin tonë kombëtar Gjergj Kastrioti-Skënderbeun Noli e çmonte si unifikues, organizator dhe prijës të rezistencës shqiptare kundër pushtuesit. Noli këtë e bëri për një qëllim, të krijonte kultin e lirisë tek populli shqiptar dhe me qëllim të krijimit të bindjes në mendësinë shqiptare se liria fitohet vetëm duke zgjedhur një prijës të denjë dhe të pranueshëm për të gjithë. Me Skënderbeun është identifikuar njeriu më i duhur që kontribuoi për një Shqipëri ndryshe, për një Shqipëri të lirë. Me të uniteti e shpëtoi popullin dhe se u përpoq ta nxirrte nga llumi shekullor i pushtimit otoman. Noli, në aspektin letrar dhe politik, u mundua të identifikohet sheshazi me të dhe reflektoi fuqishëm me veprën e tij deri sa mbaroi Lufta e Dytë Botërore.

Gjatë këtyre identifikimeve me heronjtë, Noli e përkufizon veten me kuptimin e çiftit *heroizëm/sakrificë* ose *Skënderbe/Krisht*. Në lidhje me këtë skemë karakterizuese janë vlerësuar veprimet e tij shoqërore dhe veprat e tij shkrimore duke nxënë fill pikërisht nga “*Autobiografia*”.

Noli dihet se nuk pati një qëndrim jo të gjatë në Shqipëri, që kurorëzohet dhe rrënohet me ngritjen në pushtet, në pozitën politike të kryeministrit të Shqipërisë për gjashtë muaj. Kultura e tij kryengritëse rritet gjithnjë e më shumë sa qëndroi në mërgim dhe se ka një peshë të theksuar sepse pati një qasje më këmbëngulëse në krijimtarinë poetike. Kjo kundërvënie e kryengritje gjithnjë mbetet në udhën ndërmjet predikuesit e vepruesit të prijësit shpirtëror dhe prijës politik-kryeministër. Kjo tregoi se Noli me një mendje kritike ndaj zhvillimeve në Shqipërinë e kohës, nuk është liruar fare nga modelet ideale të veprimit, madje as atëherë kur dështimet e veta politike nuk i pranonte si dështime, por si zhvillime të çastit që nuk kishin ndonjë peshë të theksuar sa të zhvlerësonte meritat që pati.

Duket se Fan Noli në hulumtimet dhe gjurmimet e tij për figurën Skënderbeut dhe përgjithësisht të kohës së tij, u bë me qëllim fisnik, të reflektojë për periudhën e cila i solli më shumë frymëzim, e motivoi t’i gjejë frymëzimet reale në veprimet politike si në Shqipëri dhe në mërgim ku qëndroi deri në fund të jetës së tij.

Autori, gjatë paraqitjes së tij, duke sjellur figura sa klerikale dhe historike, nuk solli teprime që do ta zbehnin konceptin e pastër atdhetar të tij. Noli veç çka ua shtoi madhështin këtyre veprave duke i letrarizuar me një mjeshtëri bindëse sa nga asnjë studiues deri në ditët tona nuk u shkrua asnjë rresht për të dëshmuar të kundërtën e asaj që tha në veprat e tij.

Krishti, Moisiu e figura të tjera që shfaq jo rrallëherë gjithmonë morën vend si figura të letrarizuara e aspak si figura klerikale. Noli gjithmonë solli pasqyrimet biblike me qëllim të ndërlidhjes me realitetin shqiptar të kohës. Ballafaqimet i solli të ndërlidhura me ngjarje konkrete me të cilat vetë autori ishte i interesuar të ofrojë një zgjidhje.

Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, Luigj Gurakuqi, Bajram Curri, janë emrat më të lakuar që Noli i mbarështroi në mënyrë mjeshtërore. Falë kësaj mjeshtërie Noli fitoi vend meritator në vlerësimet e larta nga studiues dhe kritika letrare.

Noli edhe ngjarjet i ndërlidhi me vendin e zhvillimit të tyre. Ai zhvillimet e këtyre ngjarjeve i la qëllimisht në vendet e njohura, në vendet të cilat nuk ishte e vështirë t’i identifikosh. Ai kishte një arsye që të mirret veç me përpunimin e temës e jo për ngritjen dhe në analizën e tyre në një vend imagjinar. Ai ishte i vetëdijshëm se kjo zhvendosje nuk do të jetë pengesë që do ta

ulte vlerën ideo-artistike të veprës. Noli me figurën e Skënderbeut nuk mendoi të fitonte ndonjë privilegj apo meritë personale gjatë gjithë veprimtarisë së tij.

2.3. Noli në kulturë dhe në jetën politike

Identifikimi me heroin moral të barazisë, me Krishtin dhe me fljimin e tij për idetë njerëzore, është i plotë. Në këto poezi është më i fuqishëm përjetimi se kudo tjetër në poezinë e Nolit. Aty ndihet me të njejtën forcë dhimbja dhe krenaria duke u ngritur në formë të adhurimit. Kjo gjë reflekton më sheshazi në poezinë “*Marshi i Krishtit*” me vargjet:

Kryetrim, që lëfton, triumfon për atdhe
Shpëtimtar, kryemjek, kryeshenjt, kryefe,
Pasuri, dhe liri, dhe fuqi ti na dhe,
Lum e lum, Galile: Hosanna, hosanna!

O i biri i Davidit, i Miri Bari
Ti na prin në luadh dhe në vërri
Ti na ruan, na mpron, dhe për ne bëhesh fli,
O njeri-Perëndi: Hosanna, hosanna!

Përmbi Dhe, përmbi Fron, përmbi Qiell u-bekofsh,
Përmbi djall dhe tiran, përmbi Ferr mbretërofsh
Me pean dhe temjan, dhe këmban’ u-këndofsh,
Drit’ e gas, rrofsh e qofsh: Hosanna, hosanna!(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I,

1988)

(*Marshi i Krishtit*)

Noli këtu del haptas në mbrojtje të individit, të vetvetes, duke elartësuar mbi të gjithë, me qëllimin e lartësimit individual, për të krijuar individualitetin prijës para shtresës së popullit, që

të dëshmojë se është mbi të gjithë dhe e meritonte pushtetin. Në masë të madhe këtu del përlulja e vegjëlisë, pa e vlerësuar se pikërisht aty mund ta kishte fuqinë më të qëndrueshme për të udhëhequr me pushtetin sa më gjatë, duke ngritur një autoportret me përshkrimin e vetes si çlirues të vegjëlisë e cila i është mirënjohëse udhëheqësit dhe shpëtimtarit të tyre.

Hosanna, o çlironjës, Mesi, hosanna!
Shtroni udhën me lule, dafin' e hurma,
Brohoritni trumbeta, timpane, zurna,
Thirr e zbras, o gurmas: Hosanna, hosanna!(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

Noli veten këtu e paraqet si drejtues ideal të atdheut dhe se përpiqej për të mirën e popullit dhe përparimin e përgjithshëm:

Kryetrim, që lëfton, triumfon për atdhe,
Shpëtimtar, kryemjek, kryeshenjt, kryefe,
Pasuri, dhe liri, dhe fuqi ti na dhe,
Lum e lum, Galile: Hosana, hosana.(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

Në këtë vjershë shfaqet mbivlerësimi i individit dhe një nënvlerësim të vegjëlisë, që i paraqet si turma të shashtisura dhe të dehura nga entuziazmi i tepruar.

Noli, figurën e Krishtit e mori si simbol të shembëlltyrës së tij personale, por menjë ndryshim se Krishti dallon nga Jezu Krishti i ungjillit që predikon lumturinë mistike në jetën e përtejme, por përkundrazi, nën fytyrën e Krishtit të Nolit dallojmë figurën e idealizuar të udhëheqësit demokrat, që përpiqet për çlirimin politik dhe ekonomik të popullit të tij.

Rreth bërthamës figuruese e konceptuale të Krishtit, ngriten në figura të tjera që lidhen me pësimin e tij gjatë përpjekjeve organizative politike në Shqipëri, me qëllim të avancimit politik të saj në radhën e vendeve demokratike dhe të përmirësimit të pozitës sociale të popullit të saj, që lidhet me të vetëdijshmen apo të pavetëdijshmen.

Jo një herë bëhen nga Noli krahasimet e tilla, duke e nxjerrë veten në piedestalin e prijësit të vetëm të kohës dhe krahasimin me figurën biblike të Krishtit, që më bindshëm del te dyzimi i temave të shpeshta të intertekstualitetit në vepër të cilën Noli e thur me mjaftë mjeshtëri. Kjo

reflekton më së miri dhe më fuqishëm në vargjet e strofës së fundit të vjershës, vargjet e së cilës i sollëm për ilustrim më bindës. Këtu Krishti (në fakt Noli) *udhëheqës, njerëz entuziast* që i gëzohen prijësit të tyre tek i cili kanë varur shpresën e shpëtimit dhe të çlirimit përfundimtar.

Noli krijoi edhe poezinë e përsosur “*Shën Pjetri në mangall*”, ku bëhet portreti i mohuesit të mikut, që zhvillohet nëpërmjet dialogut rrënoqethës. Fuqia e vjershës zbulon zjarminë e brendshme të ndërgjegjes së vrarë të Shën Pjetrit, i cili tronditet e përhumbet dhe, duke qëndruar mbi mangall njëherë “*djek dorën*”, mandej “*djek mjekrën*” dhe në fund “*djek gjuhën*”.

Këtu më së miri na del edhe stigmatizimi i gjithanshëm duke tallur dhe akuzuar të gjithë ata që fillimisht ishin betuar se do t’i dilnin përkrah.

Gjithë ata që paraqiteshin si përkrahës të denjë, mishërohen më së miri në figurën e Shën Pjetrit i cili “*kruspull mbi mangall mblidhet*” dhe mohon luftën dhe bashkëluftëtarët e tij, bindjet dhe idealet që kishin pasur bashkë. Për të më nuk kishte ide për rezistencë ndaj kundërshtarit, por vetëm ta shpëtojë veten, që ilustrohet më mirë me vargjet e shkëputura:

* * *

Kruspull mi mangallin mblidhet,
Po djek dorën dhe përdridhet;
Seç’ këndon bandill këndezi
Nga qymez

* * *

Kruspull mi mangall mblidhet,
Po djek mjekrën dhe përdridhet;
Seç’ këndon bandill këndezi
Nga qymezi:

* * *

Kruspull mi mangall mblidhet,
Po djek gjuhën dhe përdridhet;
Seç’ këndon bandill këndezi

Nga qymezi:(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

(Shën Pjetri në mangall)

Në vargjet e strofës së fundit pasqyrohet vuajta shpirtërore e Shën Pjetrit dhe ndërgjegjen e rënduar të tij:

* * *

Se ç'vajton Shën Pjetri hidhur,

Lesh-lëshuar, duar-lidhur

Tri herë e mohoj pa gdhirë,

Faqe-nxirë.(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

Edhe me vjershën “*Kirenari*” shfaqet ndërtimi tekstual i intertekstualitetit nga Noli, në të cilën portreton rastin, që hyn në histori, individin që nuk gjen përcaktim në një moment tragjik dhe se bëhet pjesëmarrës në tragjedi. Këtë situatë Noli nuk kënaqet pa e shenjësuar drejtpërdrejt në botën dhe ambientimin shqiptar. Kirenari kalon në këtë anë, por nuk është i sigurtë se mund t’u bëjë ballë mundimeve gjatë rrugëtimit të sakrificës, që shihet më së miri me vargjet:

Ç’deshe ti, mor, në Kalvar,

O qyqar, o Kirenar!

Del me poçen për sehir,

Ndrit me Kryqin si martir.

Rent nëpër kallaballëk,

Bëj gajret, mor Kirenar,

Drejt përperjetë në Kalvar!

Për paradën që bën ti

Çdo besnik të ka zili.(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

(*Kirenari*)

Në bazë të shpjegimeve biblike thuhet se ushtarët romakë, pasi kishin pushtuar tokat e Lindjes së Afërme, zunë robë protagonistin e kësaj vjershe të quajtur Simeon Kirenari të cilit ia ngarkuan Kryqin e Krishtit që ta shpinte në Golgotën e Palestinës. Me të Noli personifikon njeriun i cili nuk mban anën e askujt i cili pendohet, por gjithçka për të ishte vonë, sepse as pendesa tashmë nuk e shpëton nga ndëshkimi që merr nga romakët.

Marrë në tërësi, me tipin e Kirenarit poeti kaparaqitur njeriun i cili nuk i ka pikëpamjet e veta dhe natyrisht nëpëmjet këtij personazhi, pasqyrohet një shtresë e tërë e shoqërisë, luftën politike në mes të reaksionit dhe revolucionit e cila është e paaftë për të gjykuar drejt dhe me kohë dhe si e tillë tërhiqet në vetvete dhe nuk merr anën e askujt.

Me këtë protagonist Noli godet fuqishëm gjithë ata që s'e kuptuan fare revolucionin e udhëhequr nga ai, që të merrnin pjesë në të, ta jetësonin dhe forconin. Kirenari u tregua i paanshëm, por nuk i shpëtoi ndëshkimit, ngjashëm siç kishte ndodhur me njerëzit që s'u rreshtuan përkrah prijësve të revolucionit, por qëndruan indiferent ndaj Qeverisë së Nolit.

Në vështrimin e ndërtimit të figurës e të idesë së përmbysur me anë të ironisë, vjersha më e përsosur e këtij cikli është "*Marshi i Kryqësimit*".

Ashtu si në vjershat tjera të diskursit biblik, siç është vlerësuar edhe më parë, edhe në këtë vjershë na del qartë përdorimi i intertekstualitetit, një dyfishim i temave, një parapëlqim i njohur i Nolit në përzgjedhjen e temave për të lëvruar me sukses ato deri në përsosje:

* * *

Vrajani se përunj dhe përmbys pasurinë,
Pasuron, dhe çliron, dhe forcon varfërinë,
Se lëngatën shëron, se ndriçon verbërinë:

Kryqësoje, Pilat, në Kalvar, Golgotha.

Varreni, se me botën, me ne s'shëmbëllen.
Se na ndreq shtrëmbëritë, dhe kurrë s'na rren,
Se e do vegjëlin' e tiran' e urren:
Kryqësoje, Pilat, në Kalvar, Golgotha.

Vrajani, se për vete s'kujdeset, s'lëfton,
Dhe të mjerët, të humburit nuk i strufon,
Dhe për sherr, për vlla-vrasje, për luftë s'punon:
Kryqësoje, Pilat, në Kalvar, Golgotha.(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

(*Marshi i Kryqësimit*)

Gjuha e figurshme e përdorur në këtë poezi, dëshmon më së miri mjeshtërinë e Nolit i cili në mënyrë të përkryer paraqet njeriun altruist, që duhet dënuar sepse nuk di të punojë për vete, por angazhohet vetëm për të tjerët. Kjo gjë jo një herë na del edhe në poezitë tjera të së njejtës peshë. Me përmbledhjet e figurave biblike, Noli e mban hapin e vazhdueshëm të paraqitjeve, siç ndodh me Pilatin, një qeveritar romak i Judeut, për të cilin thuhet se vetë e dërgoi Jesu Krishtin në gjyqin fetar, megjithse nuk e besonte se i pandehuri i tij kishte bërë ndonjë krim. Vargjet e fundit të kësaj vjershe na dalin të njejtë, për ta vënë theksin e vrasjes së ndërgjegjes dhe shënjimim e fajësisë së fajtorit. Pilati vepron me një masë të tillë me qëllim të vënies së fajit izraelitëve, duke kryer një veprim simbolik të shfajësimit për vdekjen e këtij njeriu. Kalvari përmendet dendur për të treguar vendin meritore që i takonte Jesu Krishtit, por pa e pranuar fajësinë, për ta përmbyllur vjershën me vargjet:

Vrajani kryengritësin e Shenjtëruar

Si katil të mallkuar, atë ka kërkuar,

Se kujtoj që pa armë na ka për të zgjuar:

Kryqësoje, Pilat, në Kalvar, Golgotha. (Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

Në këto vargje, më shumë se një ekzekutim të tmerrshëm të një njeriu, kemi ekzekutimin e mendjes njerëzore. Përsëritja e vargut të fundit të secilës katrenë, që ngre tensionin e mundimit, vulos një krim që me jehonën e tij bëhet tejkohor, kthehet në mit, që lind nga situata reale nëpër të cilën autori shëtit qëllimisht për të nxjerrë një paralele të viktimës, Krishtit në këtë rast dhe vetes që nuk po gjente mbështetje politike fare, që ta rikthente pushtetin e humbur rrufeshë.

Studiues të shumtë janë të një mendje se vjershat e Nolit, ndonëse kanë temë biblike, nuk kanë aspak ngjyrim fetar. Figurat dhe temat e huajtura nga Bibla shërbejnë më shumë për të shprehur aspektet të ndryshme të jetës politike nga vitet 20-të të shekullit të shkuar, përmes mendimeve dhe emocioneve të vetë autorit, që ishte në epiqendër të ngjarjeve të bujshme të kohës, të cilat nuk patën jehonë vetëm në Shqipëri, por edhe më gjerë. Për pasojë, vjershat kanë edhe karakter autobiografik. Kjo rrethanë bënë që aludimet të zbulohen pa shumë vështirësi. Kjo për faktin se Noli, duke qenë bartës i zhvillimeve aktuale politike, jo rrallë herë e identifikonte vetën si personalitet të vetëm dhe të përshtatshëm për t'u prirë këtyre ngjarjeve, siç edhe ndodhi.

KAPITULLI III

3. Rëndësia e veprave të Nolit në kohën bashkëkohore

Konstatimi se Noli bënte një pasqyrim faktesh të njëanshme, dotë rrëzohej nga njohësit e mirë të krijimtarisë dhe bindjeve të tij. *Brendia e krijimeve të tij të përpunuara në mënyrë mjeshërORE e dëshmon të kundërtën dhe do t'i rrëzonte tezat e gabuara të atyre që nuk mendonin drejt për veprën e autorit tonë me plot talent dhe frymëzim.*(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

Vjershat e Nolit janë dëshmuar si vetëkritikë të ideologut dhe njeriut politik, mbi rolin e popullit dhe individit në histori. Te poezia e tij e njohur “*Krishti me kamxhik*”, me figurën e

Moisiutndikohet me tekstin biblik në tekstin letrar. Moisiu, sipas tregimit biblik, me kamxhik në dorë përzuri nga tempulli matrapazët e sarafët, plaçkitësit, që e kishin bërë faltoren “*dyqan dhe pazar tregtie*” Noli aludon për programin e tij politik. Duke u hapur me një kuadër që paraqet në mënyrë realiste kaosin, arbitraritetin dhe shpërdorimin e pushtetit nga klasa borgjeze para zhvillimeve progresive të Revolucionit të Qershorit. Noli bën hapjen e vjershës me këtë hyrje:

Në kështjellë t’atdheut, në tempull të fesë

Janë shtruar sarafët pa shpirt e pa besë,
Tregojn’ e gënjejnë, rrëmbejnë e sfrutojnë
Thon’ ashtu Israelin e mbrojn’ e shpëtojnë.

Shtrembërojnë kanunet, i marrin në dorë,
Dhe shkëlqejnë në kish’ e në fron me kurorë,
Vegjelia për ta batërdisen e vriten
Dhe kështu parasitët gjakpirësit po rriten

Tradhëtori dinak, hipokrit e kusar
Na u ngrit gjer në kulm, dhe u-bë kryetar,
Nën zgjedhën besnikët për vdekje lëngojnë,

Se mëkat dhe mallkim kryengritjen kujtojnë.(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

(*Krishti me kamxhik*)

Poeziai kapërcen kufijtë autobiografik të paraqitjes së një autoportreti nolian sepse shtron probleme të ndryshme politiko-shoqërore të kohës. Është një aluzion për kohën sa ishte në pushtet Ahmet Zogu, njerëzit e të cilit ishin hipokrit e dinakë, një fakt që e bën akoma më aktuale poezinë e Nolit dhe t’i përshtatet çdo kohe sa ka njerëz të tillë të pushteteve.

Noli këtu ngre çështje të cilat i vijon edhe në veprat tjera të tij, sidomos tek drama e njohur “*Israelitë dhe Filistinë*”. Poeti me nota të larta tregon në këto vargje se si populli nuk e duroi më gjatë tragjedinë kombëtare, por e organizoi revolucionin në krye të të cilit qëndroi ai vet.

Autori dëshiron para lexuesit të sjellëjovetëm mësimin se duhej mbështetur progresivja momentale, revolucionin që udhëhoqi, por dhe konstatimi se një gjë e tillë nuk mund të arrihej pa

u shoqëruar me forcë me qëllim të triumfit të revolucionit deri në fund. Noli pa rezervë dënon edhe veten sepse nuk e praktikoi një gjë të tillë ndaj kundërshtarëve politikë.

Pjesa më e fuqishme e sjellur para lexuesit është vënie e fajit të prijësit të butë i cila shpreh tolerancë të tepruar ndaj kundërshtarit real Ahmet Zogut, që e rrezikonte në çdo kohë, pa zgjedhur mjete të dhunës e tradhtisë, që t'i rrëmbehet pushteti dhe duke i shkaktuar atdheut dëme të mëdha.

“Je gabuar o Krisht që u ke predikuar,
Se të marrët, të shurdhërit s’kanë dëgjuar;
Ndreq kurrizin më parë, pastaj ndriço trurin.
Se shpirt-robi s’çirohet askurrë pa drurin.”

Jesu Krishti s’dëgjoj, dhe s’e mori vesh mikun,
Dhe me lot i penduar e hodhi kamxhikun,
Dhe i tha: “S’e ka fajin kurrizi, po truri,
Se lirin’ e sjell drita e mendjes, jo druri.”(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

Me këto vargje mund të nxjerrim një afri kuptimore me vargjet e vjershave “*Marshi i Krishtit*” dhe “*Marshi i Kryqëzimit*” sepse te e para, siç është nënvizuar gjatë analizës së saj, portretizohet udhëheqësi shpëtimtar, të cilin populli e himnizonte, pasi ai u kishte sjellur mirësi që nuk i kishte pasur më parë, u kishte sjellur pasuri, liri dhe fuqi. *Vetëm pas rrëzimit nga fronti, Noli e kuptoi se koncepti i tij ishte i gabuar. Dështimin e sheh te rrethanat e brendshme dhe të jashtme dhe në qëndrimin jo të qartë përballë kundërshtarëve.*(Bala, F.S. Noli - Poet, (Vështrim studimor), 1988) Noli, si duket, krijoi një ndjeshmëri të tepruar ndaj kundërshtarëve të tij politikë, meqë e thekson kundërshtinë e tij në çdo pjesë të krijimtarisë së tij, si në prozë dhe në poezitë e tij.

Ciklin e vjershave të ngjeshura me motive biblike, mund të thuhet se e mbyll poezia *Moisiu në mal* ku poeti shpreh pikëllimin dhe mjerimin, mallin dhe vuajtjen e tij larg atdheut që shumë e deshi. Poezia është autobiografike dhe përshkruan tragjedinë e kryeprofetit israelit, të dënuar nga Zoti për tëmos e parë tokën e shenjtë për të cilën pat luftuar dhe ëndërruar. Edhe kur Jehovahaj që “*flet prej një reje me zë rrufeje*”, ia kumton dënimin e llahtarshëm, Moisiu shembet për dhe i dërmuar dhe i shkallmuar duke kërkuar mëshirë dhe mirëkuptim nga Zoti, që ia ushqeu shpresat e bjerra për dyzet vjet me radhë:

Ngjitet përpjetë Malit të shkeretë
Krye-Profeti trim me fletë,
Të bisedonj me Perëndinë,
Për Palestinë.

Arrin në majë lart i kapitur,
Qëndron me frikë, pret i tronditur,
Dhe Jehovah i flet prej një reje

Me zë rrufeje:

“Ti dhe të tjerët pleq do të ngelni,
Tokën e Shenjtë kurrë s’e shkëlmi
Skllëvë, bij-skllëvësh, s’e meritoni
Se liri s’doni!”

Krye Profetit dita i ngryset
Dhe shpirt-këputur përdhe përmbysset
Me lot në sy, me zemër të ngrirë
I lyp mëshirë.

Pse kaq gjatë, Zot, më arratise,
Pse më përplase, më përpëlise,
Pse shpresën dyzet vjet m’a yshqeve,
Dhe sot ma preve?(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

Këto vargje janë më të ndjeshmet dhe më të sinqerta sepse me to autori paraqet ndërlidhjen e njejtë mes dy faqeve të ngjashme, të këqijav dhe të dhimbshme: Noli ishte ai i cili për dyzet vjet me radhë ushqeu shpresat e tij se do të kthehej në Shqipërinë e lirë. Njejtë ishte edhe me

Moisiun, i cili, sipas Biblës, nuk mundi të shkelte në tokën e Izraelit të lirë, por vetëm e pa së largu, nga maja e një mali, para se të vdiste në tokën arabe.

3.1. Ndikimi i Nolit modernist në letërsinë e kohës

E gjithë veprimtaria letrare e Nolit lidhet me aktivitetin politik të tij. Kjo gjë u tha jo një herë edhe gjatë trajtimeve në këndvështrime të shumta të veprës. Kështu mund të thuhet se Nolin sa e shohim në jetën e tij politike, po aq e shohim edhe në kulturë sepse aktiviteti i tij politik, qoftë edhe i dështuar, ka një shtrirje bukur të gjerë në tërë krijimtarinë e tij, gjë që e pasuron dykuptimësinë e shprehur në çdo poezi të tij që njohim deri më sot.

Poezia e Nolit me temë biblike jo një herë shfaq intertekstualitetin e lidhur fort, me qëllimin e vetëm të ndërlidhjes së idealeve të tij me idetë rinore të mishëruara nga ndikimet e sjellura nga kultura familjare e tij. Autorin jo rrallë e kufizonte të shprehej i lirë me fuqinë adekuate alegoria biblike. Me një ndryshim të theksuar paraqitet kjo bindje edhe në vjershat me motiv të drejtpërdrejtë, si: “*Kënga e Salep-Sulltanit*”, apo “*Kënga e monarkisë*”, siç e kishte titulluar më parë, “*Rend, or Marathonomak*”.

Për poezitë e Nolit, studiues të ndryshëm vlerësojnë se kanë një ngjarje të ndërlidhur, një ndodhi. *Nuk shfaqen në trajtën e dhembjes së monologut intim, siç ndodh te autorët e shumtë, por ndodh gjithnjë duke treguar një ngjarje nëpër vepra dhe variante etapash të ndryshme, siç na del nga ndikimet e temave të mëdha nga Bibla dhe periudhat e ndryshme historike.*(Zajmi, Fan Noli, jeta dhe vepra, 1986) Kështu poezia e tij jo rrallë herë zhvillohet nëpërmjet një dialogu, të cilën e ndërpresin komentimet autoriale apo përshkrimet e personazheve që dialogojnë në vargjet e poezisë së Nolit. Ato si të tilla, nga njohës jo të formuar mund të mirreshin ndoshta edhe si poezi të rrëfimit apo të predikimit klerikal, por nuk kanë të bëjnë fare me një ndërtim të tillë. *Humori apo satira dhe toni luftarak që i përshkon, në të vërtetë lidhen me qëndrimin e autorit për fenomenin për të cilin shkruante shpesh në poezitë e tij, pa zgjedhur motivin e veçantë.*(Noli F. , Vepra 7, 1988) Kjo gjë, jo rrallë dilte edhe në tekste poezish me temë dedikimi, që i kushtoheshin figurave të përzgjedhura nga Noli dhe ngjarjet e rëndësishme të cilat u bënë motiv i pandashëm dhe shumë frymëzime që sollën gjatë krijimtarisë së tij poetike,

pavarësisht se kishte zhgënjime të mëdha, por që s'u ndal dot së krijuari. Kjo ia shtoi vlerën ideo-artistike gjithë krijimtarisë poetike të Nolit dhe e bën atë të bëhet shembull frymëzimi për shkrimtarët dhe artistët e kohës kur krijoi sepse ju dha shembull të kthjellët se si duhej krijuar mirëfilli arti letrar.

Krahas botimit të artikujve të ndryshëm në publikimet e ndryshme të kohës, sidomos në gazetën “*Liria Kombëtare*”, Noli gjatë kësaj periudhe shkroi edhe një numër vjershash shumicën e të cilave i botoi në të njëjtën gazetë gjatë përvjetorëve të Pavarësisë së Shqipërisë. Në numrin e saj të 28 Nëntorit 1926 Noli botoi tri vjershat më të pëlqyera politike, si “*Hymni i flamurit*”, “*Syrgjin-vdekur*” dhe “*Shpell' e Dragobisë*” të cilat me të drejtë vlerësohet nga kritika e kohës se afirmuan Nolin, në masë të madhe, si njërin ndër poetët më të talentuar dhe të kohës.

Veprimtarinë poetike Noli e kishte filluar në moshën e pjekurisë, në moshën 25 vjeçare, më 1907, kohë kur e botoi vjershën e tij të parë “*Fryn moj erë*” e cila nuk ndryshonte fare nga shkrimi i poezisë, që komunikon me traditën dhe është intertekstualitet pasi autorët mendojnë se nuk duhet të shkëputen nga tradita dhe parapëlqejnë të mos i largohen traditës shqiptare. Ajo u shkrua në formën e dialogut midis poetit dhe erës që vinte nga Shqipëria.

Në shumicën e vjershave të tij Noli e paraqet veten si prijës i lëvizjes demokratike, i cili duke luftuar tiranët dhe keqbërësit e tjerë, mundohet dhe flijohet për të shtypurit dhe shtresën e varfër të popullit të tij. Me një fjalë, nëpërmjet këtyre vjershave të tij, Noli e ka paraqitur gjendjen e vërtetë dhe faktike që mbretëronte gjatë asaj kohe në Shqipëri, pa pretendime që ta zbukuronte apo ta shëmtojë realitetin ekzistues.

Me thurjen e këtyre vjershave Noli e pasuroi lirikën tonë të shkruar me poezitë shoqërore-politike përmes të cilave shprehu përjetimet dhe zhgënjimet e një periudhe të caktuar kohore të historisë vendimtare të formimit të shtetit kombëtar të ne shqiptarëve.

Edhe poezia *Kënga e monarkisë*, apo siç u titullua më vonë “*Kënga e Salep-Sulltanit*” u shkrua në kohën e sundimit të Ahmet Zogut, më 1928 me të cilën Noli ka për qëllim ta thumbojë monarkun shqiptar i cili sapo e kishte kurorëzuar veten mbret i shqiptarëve. *Poezia është një satirë e fuqishme me të cilën Noli nuk mund ta pranonte faktin se Shqipëria e tij që deshi të kthehej prapa në sistemin e monarkisë, kur shtetet tjera po ndërtonin demokracinë.*(Noli F. , Vepra 7, 1988) Noli sulmon jo vetëm mbretin, por edhe gjithë klikën e tij që e përbënin një mori horrash e dallkaukësh të llojllojshëm, të cilët ishin të njohur si fajdexhinj e njerëz ryshfeti, që e

rjepnin popullin pa mëshirë, në kohën kur pjesa dërmuese popullit e sidomos malësorët, vuanin tërë kohën për kafshatën e gojës.

Veç kësaj, vjersha pasqyron degjenerimin e nëpunësve të lartë, kapadai dhe batakçi, të cilët nuk çanin kokën për urinë, për paditurinë dhe mjerimin e përgjithshëm të popullit. Të gjithë këta, përfshirë shërbëtorët më besnikë të këtij regjimi, i përuleshin dhe e lajkatonin mbret-sulltanin e tyre vetëm për të përfituar personalisht sa i shërbenin atij.

Ironia arrin kulmin sidomos në vargjet ku paraqitet amullia në të cilën dremitej vendi gjatë regjimit çifligaro-borgjez të Ahmet Zogut. Përdorimi i fjalëve turke bëhet me qëllim nga autori, pasi njerëzit e morën fenë nga Osmanët, tani edhe gjuhën. Shkrimi i fjalëve në gjuhën turke ia bën më të lehtë lexuesit të kësaj kohe ta konceptojë poezinë dhe ta kuptojë kritikën e Nolit i cili kishte guxim ta bëjë edhe në kohë mbretërie:

* * *

Seç u-çporr xhumhurieti,

Seç u-rahatos mileti,

Se Sulltanin prapë e gjeti,

Se, që-kur e humbi, s'fjeti!

Ç'ka sepse i vjetri qe

Madhështor sa një deve

Dhe ky s'bëhet as për meze

Rroftë sa jep ylefe.(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

Në këtë satirë Noli nuk ngurron t'i përmend edhe me emër gjithë bashkëpunëtorët e mbretit Zog dhe gjithë ata të cilët një ditë më parë e shanin atë pa pushuar e sot i thurnin lavde:

Një mexhliis të math na çeli

Pandeli Jano Vangjeli

Me Sulltan-llokum na veli

Si kofinipas të vjeli.

* * *

Dhe rakia vete-vjen,

Xhafer Ypi na mbërthen
Dhe për tot na mallëngjen
Rreth konopit me legjen.

Koço Kotta, mjek hanxhari,
Nis një valle palikari,
Se me një ferman Kusari,

Sadrazem u-bë firari.(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

Noli satirizoi dhe krijon ndërkommunikim me bashkëkohanikët e tij, të cilët nuk i qëndruan besnik dhe nuk e mbështetën pas dështimit të Revolucionit të Qershorit. Noli satirizon pavendosmërinë e tyre, që para revolucionit kishte shkruar disa artikuj kundër Zogut, por që tani e përkrahte atë:

* * *

Dhe Feridi faqe ndron,

Die shante, sot lëvdon

Fryn bulçit' e trumpeton,

Që Katrani zbardhëllon.(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

Vështruar në tërësi, me vjershën “*Kënga e Salep-Sulltanit*”, autori ka synuar ta damkosë jo vetëm mbretin Zog, me oborrtarët e tij, por një shoqëri të tërë çifligarësh e agallarësh, tuxharësh e xhandarësh që përbënin shtresat më të errëta të vendit.

3.2. Jeta politike e Nolit dhe reflektimi i saj në vepër

Me të drejtë thuhet se Noli dhimbjen, zinë e krenarinë për simbolin e liberatorit, do ta këndojë në rrafshin e dhembjes krenare personale duke i thurur pikërisht elegjitë e tij të njohura për bashkëpunëtorët e vet. Nuk mund të thuhet se Noli vetëm satirizon bashkëkohanikët e tij. Ai ngrehimne për ata që ishin krenaria e kombit tonë, që lanë gjurmë të pashlyeshme në historinë tonë, siç ishte Luigj Gurakuqi dhe Bajram Curri. Të dy elegjitë e përmendura i shquan dhe i

pushton i njejt i ton që nis me dhimbje e mbaron me krenari, duke u përpjekur që ndërtimi i vjershës të jetë në pëlqim me personazhet e kënduara-vajtuara.

Noli jo një herë poezitë kushtuar Luigj Gurakuqit “*Syrgjin vdekur*” dhe Bajram Currit “*Shpell’ e Dragobisë*” i quan elegji, gjë që edhe nga studiues të shumtë janë konsideruar të tilla për shkak të notave emocionale që shpreh Noli fuqishëm, duke bërë kështu, qëllimshëm një ngritje të dy figurave historike në piedestalin më të lartë të mbarmendjes që janë kolektive shqiptare.

Mënyra se si janë dhurur këto dy vjersha dhe toni i tyre dhe ajo që u tha për dy personalitetet e njohura nga politika dhe vetë Ahmet Zogut, parashtrajnë pyetjen se sa dhe cilat janë elementet që janë karakteristike për disa nga llojet kryesore të poezisë lirike. Pa e diskutuar shumë, dimë se oda është gjithnjë poezi e një toni të lartë që i jepet besimit të fundit të një personi të dashur, apo shumë të respektuar, siç ishin në të vërtete edhe Luigj Gurakuqi në njërin anë, përkrahësi më i denjë politik i Nolit dhe Bajram Curri, luftëtari i demokracisë shqiptare, në anën tjetër.

Te Bajram Curri, një trim dhe udhëheqës i shtresës së ulët, të cilin Noli më pak e vajton se sa shprehte besimin e fundit, besimin se qëndrimet dhe veprat e tij do të mbesin në historinë e të varfërve, atyre që gjithmonë do t’u ngjallnin frikën klasës sunduese e cila mendonte t’i nëpërkëmbte dhe të mos mirrej me ta, me qëllim të përmirësimit të kushteve sociale. Është më se e vërtetë se një dhimbje e thellë e brendshme derdhet me shprehje të fuqishme, me ngjyra e tone heroike dhe reflekton në dy poezitë. Kjo dhimbje shkon thellë po aq sa është e brendshme për poetin. Noli në to edhe kur vajton, vajton me krenari të lartë dhe me mburrje të veçantë duke u përpjekur, në radhë të parë, të nxjerrë në sipërfaqe idealet e pastërta të dy tribunëve të kombit dhe në anën tjetër të kundërshtarëve politikë të revolucionit të udhëhequr nga Noli.

Dhembjen, zinë e krenarinë për simbolin e liberatorit, Noli do ta këndojë në një rrafsh të dhimbjes personale jo rastësisht për dy figurat shumë të dashura për lexuesin. Të dy elegjitë kështu i pushton i njejt i ton që nis me dhimbje dhe shndërrohet në krenari, duke u përpjekur që ndërtimi i vjershës të jetë në pëlqim me personazhet e kënduara-vajtuara. Në elegjinë e parë që ia kushton Luigj Gurakuqit “*Syrgjin vdekur*” thelbi i saj gjendet që në strofën e parë:

Nënë moj, mbaj zi për vllanë,
Me tre plumba na i ranë,
Na e vran’ e na e shanë

Na i thanë tradhëtor.(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

(*Syrgjin vdekur*)

I gjithë tragjiciteti i kësaj elegjie ngritet mbi vrasjen jashtë vendit të njeriut i cili e deshi më së shumti Shqipërinë, të njeriut që kontribuoi së tepërmi për të ndërtuar një vend për të gjithë. *Tragjiciteti i gjithë vrasjes rritet më shumë kur atdhetari i shquar nga të gjithë shpallet tradhtar dhe vritet, duke krijuar kështu modelin e tmerrshëm të heroit shqiptar, i cili duhet ta provojë gjithnjë veten me gjestin më sublim, duke dhënë jetën, duke e ilustruar më së miri me vargjet e shkëputura më lart.*(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)Noli Gurakuqin e quante vëlla, si në poezi ashtu edhe në jetën e përditshme. Ai e bëri këtë shprehje me qëllim për të treguar afrinë që ka në ideale dhe veprime të njëjta në të mirë të ndërtimit të një Shqipërie ideale për gjithë ata që e deshën të lirë atë.

Ndonëse fshehja e krimit pas vrasjes së Luigj Gurakuqit provohej të bëhej pas shprehjes “*tradhtor*”, nuk piu ujë te Noli dhe atdhetarët e shumtë të cilët e kishin njohur më së miri atë duke qenë prijtar i shumë ngjarjeve të mëdha, autor i shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë:

* * *

Nëno moj, vajto, merr malin

Larot t’a përmbysnë djaln

Që me Ismail Qemalin

Ngriti flamur trimëror.(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

Nëna, këtu, gjithnjë është Shqipëria, është më meritörja për të cilën ishte sakrifikuar gjithnjë nga bijtë e saj. Noli të flijuarin për të e mvesh me epitete reale, për të dhënë të kuptojmë sekomunikon me historinë si aspekt të intertekstit që është edhe historia. Luigj Gurakuqi i tillë ishte, njeri që jo se s’kishte vese të këqia, por as fjalë të papëlqyera:

* * *

Nëno moj, ç’është përpjekur

Gojë-mjaltë’ e zëmër-hekur,

Syrgjin gjall’ e syrgjin-vdekur,

Ky Vigan Liberator.(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

Sipas analogjisë dhe krahasimit në poezinë për Luigj Gurakuqin, të cilin e quante vëlla Noli ishte i bindur se në këtë mënyrë do të mund të shprehë pikëllimin dhe mburrjen për të, por kjo duhet kuptuar vetëm si vëlla më i madh, hapave të të cilit duhet të shkohet për të arritur atë që e kishte arritur Luigj Gurakuqi. Andaj edhe te “*Shpell’ e Dragobisë*” del se poeti edhe Bajram Currin e çmonte mjaft, por merita e tij sikur i takonte së kaluarës. Bajram Curri për poetin është babë, pra dhembja për të nuk është e vogël, por jo edhe e madhe si për vëllaun, krahun e djathtë të tij që e kishte në çdo vend dhe në çdo kohë.

Përkundër vlerësimeve që ju bën dy figurave, të Luigj Gurakuqit dhe Bajram Currit, luftëtarin dhe hero malesh, Noli ka mundur t’i vijëzohë fare mirë portretet e tyre. Sa ishte në mërgim vritet njeriu i dashur i tij, në përpjekje gjithnjë për të mirën e vendit, i cili edhe vetë kohën më të gjatë të jetës së tij e kishte kaluar në mërgim, prandaj e thekson se ai mbeti në mërgim edhe i gjallë edhe i vdekur. Përskrimet janë dhënë me mjete të zgjedhura artistike, me fjalë që reflektojnë shfaqjen e dashurisë së Luigj Gurakuqit për atdheun:

* * *

Se të deshte dhe s’të deshnin,

Se të qante kur të qeshnin,

Se të veshte kur të ç’veshnin,

Nën’onmoj, të ra dëshmor.(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

Si njëren edhe në vjershën tjetër, autori nuk shpëtoi pa i thumbuar me nota alegorike ata që i kishin shkaktuar dëme të rënda vendit, kundërshtarët e tij politikë. Madje në këtë poezi Noli nuk e ngre revoltën me sarkazmë vetëm ndaj tradhtarëve, por edhe ndaj vendit, atij që nuk i kishte dhënë vend as për varr:

* * *

Nëno moj, m’a qaj në Vlorë

Ku të dha liri, kurorë,

Shpirt’ i bardhë si dëborë

Ti s'i dhe as varr për hor.(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

Noli me një përkushtim të lartë e paraqiti figurën e Bajram Currit, të një njeriu i cili tërë kohën kishte qëndruar në vendin e tij, pra nuk kishte mërguar si Luigj Gurakuqi. Ai qëndroi i palëkundur në malet e atdheut të tij dhe se ishte në kontakt të vazhdueshëm me shtresën e nëpërkëmbur, vegjëlinë. Atë jo rastësisht nuk e quajti Ante, njeri vigan:

As je vrrar' e as po vritesh

Legjendar Ante po rritesh.-

Dithiramb i Dragobisë

Tmerr panik i mizorisë.(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

Edhe për popullin, figura e Bajram Currit ishte shumë e dashur. Ai luftoi përkrah njerëzve më besnik të rrethit të Gjakovës, por kurrë nuk i kishte shkuar në mendje se mund të tradhetohej prej tyre. Edhe pas vdekjes Bajram Curri do të mbetet i dashur nga të gjithë edhe pas zhdukjes fizike në malet e Dragobisë. Noli është i bindur se rrugën e tij do ta ndjekin të gjithë pa dallim, por gëzim përjetuan vetëm shtresa e lartë e cila nuk brengosej fare për mirëqenien e popullit.

Këtë gjë Noli e theksoi gjithnjë me nota artistike fuqishëm:

Thon' u-shtri e thon' u-vra

Po ti s'vdiqe, or Baba,

As te shkëm'b i Dragobisë,

As te zem'ra e Dragobisë.(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

Bajram Curri edhe për së vdekuri bëhet tmerr i tradhtarëve të vendit, të atyre që nuk mendonin prosperitetin e tij në asnjë kohë. Kjo paraqitet me të vetmin qëllim për ta shpreh pavdekësinë e tij, që hyri thellë në kujtesën e popullit të shumëvujtur.

Natyra e ashpër në të cilën ishte rritur heroji, shkrepat e larta dhe të pamposhtura, u bën lajtmotiv i qëndresës heroike ndër shekuj. Vrazhdësia e shkëmbinjve të thepisur dhe maleve e shpellave ku heroji e kaloi pjesën më të madhe jetës së tij, reflekton qartë në fytyrën e tij, në qëndrimet gjakftohta.

Me përshkrimet mjeshtërore që i bën Noli figurës së Bajram Currit, del se i jep tipare të qarta të burrit i cili bëhet model frymëzimi dhe orientim në çdo kohë duke e ilustruar më së miri me vargjet:

* * *

O Bajram, bajrak i gjallë,
More nam me gjak në ballë,
Te një shpell' e Dragobisë
Yll i rrall' i burrërisë.(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

Fan Noli shfaqet të jetë një mjeshtër i rrallë që di t'i jap vargut një muzikalitet të paparë te autorë të tjerë të kohës së tij. *Ai zgjedh mjetet dhe shprehjet poetike duke ngritur tiparet e personalitetit për të cilin këndon e shkruan dhe mandej t'i radhis elementet që duhen përmendur në mënyrë të tillë që poezia nga fundi i saj të bëhet më e fuqishme për të përfunduar me tone triumfuese me të cilat shprehet e shfaqet ideja dhe qëllimi kryesor i autorit, ndonëse ai në poezi këtë element e thekson edhe më parë.*(Krasniqi, Inteligjencia, letërsia dhe realiteti, 1989)Vlerësimet se ishte mjeshtër i nivelit të lartë i thurjes së vargut poetik janë aktuale edhe sot.

Te poezia “*Syrgjin vdekur*” autori filloi me një ton pikëllues me rastin e vdekjes së protagonistit, vazhdon me të dhënat që dëshmojnë për meritat e tij dhe paraqesin portretin e tij për të përfunduar me strofën që shpreh jo vetëm virtytet por edhe madhësinë e këtij luftëtari që u përpoq për lirinë e vendit.

Te poezia “*Shpell' e Dragobisë*” në mënyrë artistike në fillim e paraqet kohën se kur u zhvillua ngjarja tronditëse, për të filluar ngjashëm me ndriçimin e personalitetit të Bajram Currit, me theks duke sjellur pavdekësinë edhe pas vdeksjes së heroit, duke vijuar me shpresën e poetit se shembëlltyra e tij do t'u shërbejë gjeneratave të tëra që do të vijnë më pas për një luftë më të organizuar ndaj kundërshtarëve të revolucionit që udhëhoqi Noli.

Figurat e ndryshme stilistike si, metaforat, kontrasti, krahasimi janë përdorur dendur në këto dy poezi fuqishëm për të bërë një lidhje kuptimplote me personalitetet që përshkruan, të Luigj Gurakuqit dhe të Bajram Currit. Një gjë e tillë autorit i ka dhënë mundësi që me pak fjalë të përmbledhë elementet e ndryshme në dy poezi të tij, për të paraqitur më qartë dhe me mjeshtëri.

Si në vjershën kushtuar Luigj Gurakuqit, ashtuedhe te poezia për Bajram Currin, Noli përdori me të madhe fjalë të huaja të cilat janë të shndërruara në simbole përkatëse, të cilat jo vetëm nuk ulin vlerat autentike të poezive të tij, por ua shtojnë vlerat dhe funksionalitetin artistik. Këtu, krahas fjalëve dhe shprehjeve të huaja, kemi dhe fjalë të moçme shqipe, të cilat kanë një përdorim fare të pakët në krijimtarinë poetike. Ato në krijimtarinë e Nolit kanë gjetur vend dhe përdorim më të shpeshtë dhe se domethënia e tyre është shumë më e madhe se sa shihet në fillim. Trajatat e ndryshme poetike që përdor Noli janë të paraqitura me një natyrshmëri mjeshtërore dhe një lidhje të mrekullueshme. Si të këtilla ato shfaqin qëndrime dhe respekt nga poeti ndaj bashkëluftëtarëve të tij në përpjekje për të themeluar shtetin e parë demokratik. Bashkë me rimat e shfaqura te poezia “*Syrgjin vdekur*”, që në vargjet e para të saj dhe për të vazhduar pastaj edhe me vargjet tjera të çdo strofe, për të arritur një efekt vertikal që ngritet kundër efektit horizontal të rimave tjera.

Është me rëndësi ta sjellim mendimin e Nolit që kishte për poezinë sepse jeta e tij gjithnjë doli të jetë e lidhur me poezinë, pra me autobiografinë. Noli mendonte se arti duhej të paraqitej sheshazi, pa bërë as fshehjen më të vogël të realitetit.

3.3. Realja e shfaqur në vepër, qëllimet

Më 1947 Noli botoi dy studime “*Historia e Skënderbeut*” dhe “*Bethoveni dhe Revolucionin Francez*” që u referohen dy fushave të tij të dashura, historisë e muzikës. “*Historia e Skënderbeut*” e botuar në Boston. Burimet kryesore në hartimin e kësaj vepre Noli i gjeti tek vepra e Marin Barletit dhe në burime të tjera. “*Historiae Skënderbeut*” e Barletit dhe e Nolit mbetën veprat monumentale mbi heroin tonë kombëtar të shkruara deri më sot dhe ndër veprat më të lexuara.

Autori veprën e ndau në katër kapituj; *Lufta kundër turqve gjer në Kuvend të Leshit; Skënderbeu kundër sulltan Muradit II; Skënderbeu kundër sulltan Mehmetit II; Skënderbeu dhe Venetia kundër sulltan Mehmetit II.*

Në fillim të veprës Noli jep një pasqyrë të shkurtër të ngjarjeve historike e shoqërore të kohës deri në shfaqjen e Skënderbeut në Kuvendin e Lezhës dhe emërimin e tij për komandant të përgjithshëm të forcave shqiptare.

Thelbin e veprës e përbëjnë përshkrimet e përgjithshme të luftërave të njëpasnjëshme të Skënderbeut si ajo e Torviollit, Mokrenës, Oranikut etj. deri te rrethimi dhe rënia e Sfetigradit dhe Beratit. Për secilën luftë Noli paraqet numrin e ushtarëve që marrin pjesë në të dy anët, emrat e komandantëve që i udhëheqin ushtritë kundërshtare, taktikën e përdorur, kohën e zhvillimit të luftës dhe përfundimin e saj. Me këtë rast nuk harrohet edhe numri i të vrarëve, të plagosurve dhe robërve, bashkë me armët dhe plaçkat tjera që bien në duar të fituesve. Autori pas gjithë kësaj bën fjalë edhe për jehonën e këtyre luftërave në botën e jashtme e sidomos tek aleatët. Noli hyn edhe në disa detaje duke dhënë përshkrime të hollësishme të ndonjë episodi, si fjala vjen, kur tregon grindjen që ndodhi në mes Lekë Dukagjinit dhe Lekë Zaharisë për shkak të Irenës së bukur në dasmën e Mamices, motrës së Skënderbeut. Kjo ngjarje pati një bilanc tragjik sepse përfundoi me njëqind të vrarë dhe mbi dyqind të plagosur nga të dyja anët.

Autori e përshkruan me besnikëri mjedisin feudal, marrëdhëniet midis princave, egoizmit të njërit dhe tjetrit duke parë në këtë rivalitet ndikimin e Venedikut apo intrigat e sulltanëve turq, që përpiqeshin t'i përçanin princërit shqiptarë me dredhi për t'i gjunjësuar e gllabëruar në tërësi...

Dihet se Noli nuk kishte konsultuar fare literaturë për jetën dhe të bëmat e Skënderbeut, veç një numri veprash të autorëve shqiptarë, që kryesisht ishin të njëanshme.

Nga burimet kryesore letrare shqiptare për Historinë e Skënderbeut, Noli do të ketë dy biografët e mëdhenj, Tivarsin e Barletin, veprat e të cilëve plotësohen nga dy biografë të tjerë, Dhimitër Frangu dhe Gjin Muzakës. *Deri vonë besohej se vetëm Barleti ishte biografi i Skënderbeut, mirëpo prifti italian Biemi gjeti një biograf anonim më të hershëm nga Tivari vepra e të cilit ishte shtypur më 2 prill 1480.*

Babingeri, dijetar gjerman dyshon për Biemin dhe e quan atë falsifikator. Nuk dihet se kush ishte autor i kësaj vepre, por mendohet se ishte Pal Engjëlli nga Durrësi i cili ishte me punë në Tivar. Libri i tivarsit humbi gjurmët dhe ai i Barletit ruajti gjurmët dhe u ribotua në disa gjuhë. (Zajmi, Jeta dhe vepra e Fan Nolit, 1988)

Noli krijoi një Skënderbe ideal, një udhëheqës të tipit legjendar me disa tipare fantastike, ashtu siç e kishte imagjinuar në vegjëli. Noli Skënderbeun e krahasonte me strategët më të mëdhenj ushtarakë, si Aleksandrin e Madh, Hanibalin, Jul Cezarin, Napoleonin etj. Ndjenja e adhurimit ndaj heroit kombëtar duket që nga viti 1908 në artikuj të ndryshëm, kohë kur Noli ishte ngazëllyer nga ngritja e flamurit kombëtar në kështjellën e Krujës dhe i thërret armiqtë:

“Eni tani, ju anadollak t’a zbrisni flamurin që ngriti biri i Shqipërisë. Që tani e tutje s’ka gjimë! Luftë pa prëhje gjer në vdekje, luftë natën, luftë ditën, luftë në brigjet, luftë në fushat, luftë në shkëmbijtë, luftë në përrejtë, luftë për Shqipëri, luftë për nder e për liri”(Noli F. S., Skënderbeu, Shkrimtarët shqiptarë II, 1941)

Nëpërmjet këtyre figurave dhe veprimeve të tjera, veç figurës së Skënderbeut, përshkruhen figurat e kundërshtarëve e shpesh herë të bashkëluftëtarëve, si Vrana Kontit i cili për gjashtëmbëdhjetë vjet me radhë i shërbeu me besnikëri Skënderbeut, duke e mbrojtur me guximin më të lartë kalanë e Krujës. Njëjtë u paraqit edhe Moisi Golemi, krahu i djathtë i Skënderbeut e një ndër gjeneralët më të dalluar të ushtrisë shqiptare, i cili kishte fituar admirimin dhe famën e gjithë shqiptarëve për guximin dhe zotësinë e tij në sheshin e luftës. I pashoq ishte edhe Hamza Kastrioti, i nipi i Skënderbeut, i cili, ndonëse kishte tradhtuar, shquhej për trimëri.

Vepra *“Historia e Skënderbeut”* u bë një libër i popullarizuar për të gjitha moshat dhe lexohet me shumë ëndje nga të gjithë me të cilën autori u bë i famshëm edhe si historian dhe artist i talentuar.

Në vazhden e punës kërkimore-shkencore, Noli më 1947 nxori në dritë anglisht një tjetër *“Histori të Skënderbeut”*, të cilën në fillim e parashtroi si disertacion kur doktoroi në filozofi në *Universitetin e Bostonit*, ndërsa më vonë e përpunoi dhe e zgjeroi për publikun duke ia shtuar burimet, bibliografinë etj. duke bërë që vepra të radhitet ndër veprat e përpunuara shkencore.

Që në hyrje të veprës, Noli thotë se *“Çdo heroi në histori, i është dashur të kalojë nëpër tri fazat glorifikuese, të asgjësimit dhe rivlerësimit”*. Me një përvojë tjetër krijuese, Noli zgjodhi një rrugë tjetër duke mos i ndjekur admiruesit që heroin e tyre e kishin ngritur në qiell. Ai ndjek një rrugë të tretë dhe më reale që do të jetë aq larg egzagjerimeve panagjerieke si dhe nga shtrembërimet dhe egzagjerimet e falsifikuesve të palës tjetër.

Nga hulumtimet e bëra dhe të dhënat e dokumentuara më vonë, është konstatuar se fjalët e Barletit, në të cilat është mbështetur Noli, nuk kanë qenë gjithmonë trillime siç kanë pohuar gjithnjë disa studiues të huaj, që e quajtën librin e Barletit një gënjeshtër mbi Skënderbeun.

Po me këtë qëndrim kanë edhe autorët turq, të cilët s’ndjenin gjë tjetër veç përbuzje. Të gjitha këtyre shkrimeve përçmuese Fan Noli do t’u përgjigjet me forcën e argumenteve duke vënë në dukje faktorët e jashtëm. Ai pohon se Skënderbeu në luftërat e tij nuk ishte i vetëm. Atë e përkrahën aletët e fuqishëm, siç ishin Papati, Venediku, Raguza, mbretëria e Napolit etj. të cilët i dhanë armatime, ushqime, ushtarë etj.

Një faktor tjetër që ka kontribuar në përforcimin e pozitës së Skënderbeut, kanë qenë edhe trupat e qëndrueshme të paguara me rrogë, të cilat e bënë kryetrimin të jetë i pavarur nga feudalët. Këto ishin kryesisht repartet e rregullta, pak a shumë të specializuara për detyra të veçanta, si ato të gardës, të rojes së kështjellave etj.

Veç kësaj, Fan Noli vë në spikamë se Skënderbeut dhe luftëtarëve të tij i ndihmuan edhe faktorët gjeografikë, shoqërorë dhe ekonomikë, që vepronin në dobi të tij dhe së fundi vetë shpirti luftarak i shqiptarëve lirishtës që më tepër preferonin vdekjen se robërinë.

Që në fillim të veprës autori rikujton se meritë kryesore për fitore i takon popullit duke mos harruar edhe rolin e prijësve luftarakë e sidomos të Skënderbeut, i cili çdo ditë u binte tendave të armikut duke ju shkaktuar dëme të konsiderueshme atyre. Aty Barleti përshkruan edhe familjen e kastriotëve. Noli e përshkruan edhe numrin e ushtarisë së sapo formuar nga Skënderbeu në kuadrin e së cilës përveç gardës së tij personale përfshiheshin tetë deri dhjetë mijë luftëtarë e këmbësorë e kalorës të lehtë që mund të lëviznin me një shpejtësi të rrufeshme.

Veprën për Skënderbeun, të botuar më 1947 Noli përpiqet ta mbështes në të dhënat e padyshimta. Ai ka gjurmuar dhe sjellur burime të besueshme duke nxjerrur dokumente të shumta historike. Në bibliografinë e sjellur nga Noli citohen rreth 200 vepra, artikuj e studime të autorëve të ndryshëm, të cilët kanë shkruar për jetën dhe veprën e Skënderbeut dhe për probleme të ndryshme të kësaj epoke.

Noli e përqëndroi vëmendjen e tij në disa çështje kyçe të ndryshme dhe që kryesisht ditaditës kanë ngelur kontestuese.

KAPITULLI IV

4. Reflektim i jetës shqiptare

Fan S. Noli e pa Shqipërinë me fantazinë e idealistit dhe gjithnjë pati qasje konstruktive ta trajtojë drejtë me realizëm me qëllim që të sjellë një realitet ashtu siç ishte por me dëshirë se si të arrinte ta ndryshonte atë. Ai e deshi Shqipërinë e tij të ishte vendi më i përparuar dhe jo në atë gjendje tëprapambetur ekonomike, politike, arsimore dhe në aspektin kulturor.

Shpallja e pavarësisë dhe çështja e sigurimit të saj e aktivizuan edhe më shumë atë dhe e formësuan dukshëm në krijimin e një qasje atdhetare dhe të formimit intelektual dhe politik, që do të reflektojë dukshëm në veprimtarinë e tij në të ardhmen.

Kjo jo njëherë shfaqet në veprën e tij e veçanërisht në poezi në mënyrë të drejtpërdrejtë, te poezia “*Hymni i flamurit*”, të cilin me të drejtë autori e quan *nënë, babë, motër, vëlla* etj.

Strofa e parë është themelorja dhe me vargun e metaforave ngrit përmendoren poetike të flamurit shqiptar duke e identifikuar pamjen e tij me simbolet e qenësisë shqiptare.

O Flamur gjak, o flamur shkabë,

O vënd e vatr’ o nën’ e babë,

Lagur me lot djegur me flakë

Flamur i kuq, flamur i zi.(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

Afria që tregon me flamurin kombëtar e bën në një përditshmëri për të treguar se nuk ka distancë mes flamurit dhe shqiptarit të kohës deri sa të bëhet një mburojë qëndrese si në çdo kohë.

Në vijim flamuri si shenjë kombëtare, zbulohet duke provuar një histori kombëtare, kulturore e politike, që simbolizojnë pushtuesit e ndryshëm gjatë zhvillimeve historike:

Fortesë shkëmbi tmerr tirani,

S’të trëmp Romani, as Venecjani,

As Sërp Dushani, as Turk Sulltani,

Flamur i math për Vegjëli.(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

Noli me këtë poezi bën edhe lidhjen kombëtare, për të vijuar me vargjet:

Flamur që lint Shën Konstandinin,

Pajton Islamn' e Krishtërimin,

Çpall midis feve vllazërimin,

Flamur bujar për njerëzi.(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

Hymni është një këngë solemne me të cilën autori nxjerr në shesh veçantitë kombëtare shqiptare. Edhe me këtë vjershë Noli dëshiron t'i lidhë këto veçanti.

Noli si poet, dramaturg, kritik e përkthyes krijoi një stil të vetin krejt të dallueshëm nga të tjerët, që u ndoq dhe u imitua më vonë në letërsinë shqiptare nga shkrimtarë dhe artist të rinj. *Lidhja e Islamit me Krishtërimin* këtu ka simbolin e fuqisë së brendshme që ka njeriu, pa reflektuar në ndasi, meqë Noli këtë realitet e njihte mirë dhe nuk e ndante fare.

Në këtë poezi, me Skënderbeun dhe Malon (këtu Ismail Qemalin), autori jep ngritjen politike të flamurit tonë kombëtar, për të ruajtur në vijimësi ecejakjet e tij nëpër histori:

Me Skënderbeun u-lavdërove

Dhe në furtun' i funtmi u-shove,

Me Malon prap lart vrapove,

Yll i pavdekur për liri.(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

Në këtë vjershë Noli shfaq simbolizmin e tij të theksuar poetik. Simbolet e flamurit: *fushë-kuq* e *shkabë-zi* janë përfituar si e qëndresës njerëzore:

Sa shpesh pastaj për-dhe u-shtrive

Me zjarr e zi u-ndeze u-nxive,

Po çdo mizor me shpat' e grive,

O fushë-kuq, o shkabë-zi.(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

Fundin e poezisë autori na e jep në trajtë të lutjes sepse këtë vjershë autori mëton ta ngris në një himn kombëtar, në një shkallë ku do të citohej nga gjithë shqiptarët:

Përpjetë pri-e Shqipërinë,
Përlintj' a shpirtin dhe fuqinë,
Diell për vëllanë, yrnec për fqinë

Për botën ëndër' e qiell i ri.(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

4.1. Drama jetësore e Nolit, dialog me Biblën

Reflektim shumë i denjë i kësaj çështje shfaqet edhe në veprën shumë të çmueshme të Fan Stilian Nolit, dramën “*Israelitë dhe Filistinë*” të cilën autori e shkroi në Athinë, më 1902 gjatë kohës sa punonte në teatër. Dramën e botoi pesë vite më vonë, më 1907 në Boston të Amerikës. Gjatë kësaj kohe Noli mendonte ta përpunonte, por nuk ia doli. Ai dramën e quan veprën *sqelet dramë, foshnjë-dramë*, duke mos shprehur rezervat e tij për përsosmërinë e saj dhe e mbylli atë me fjalët: *Për andaj ua heth vëllezërve t’im si një enigmë, shohim kush do ta zgjidhë*. Në këtë mënyrë Noli sugjeron leximin e veprës së tij si zgjidhje të enigmës.

Drama e merr temën nga Bibla, por nuk ka ndodhi intriguere në strukturën e saj dramatike. Fuqia e kësaj drame qëndron në idetë e saj dhe më tepër në pyetjet që shtron autori para lexuesit me “*enigmën*” e tij. Në këtë dramë shfaqen dilemma të ndryshme që reflektojnë në veprat e tjera të tij.

Drama “*Israelit dhe Filistinë*” ka tri akte.

Akti i parë zhvillohet në Sinagogën e Judejve, ku prijësit e tyre ishin mbledhur t’i jepnin bekimin Samsonit, i cili merr përsipër ta sjellë në rrugë të drejtë botën e filistinëve. Zhvillohet një bisedë ku shprehen bindje të ndryshme. Kishte mospajttime të shumta për atë sa thuhej aty. Samsoni ka bindjen se do ta kryejë detyrë duke u mbështetur në fuqinë e fjalës dhe së vërtetës.

Përkrahjes së përgjithshme që i bëhet Samsonit nga të pranishmit, i kundërvihet Rabini. Rabini kishte pikëpanje krejt të ndryshme nga të tjerët. Ai mendonte se filistinët duhet të nënshtroheshin me forcë. Përkujton një aksion të ngjashëm që kishtëmarrë vetë i dytë, tridhjetë vjetë më parë. Miku i tij ishte mundur nga pabesia e jetës filistine, paratë dhe femrat e bukura filistine. Kundërshtimi i Rabinit merr formën: *“E vërteta s’është përveç një dobëti kur s’i vjen pas një forcë e realtë”*.

RABINI

Do t’ju them një përrallë të vogël qh e pashë me syt’ e mi. E nëmëronjë për përrallë, se s’është gjë për të besuar, po e besonj, se u bë më kot Bota.

TË GJITHË

Eja, thuajna.

RABINI

Mbanj nër ment se para 30 vjeç u bë një konferencë si kjo prapë për këtë qëllim. Më kot u kundërshtuash dhe atëherë, se s’ish e para herë që e pësonja po kush të dëgjon? Thanë dhe kuturisë, dhe për bela dhe më dërguan mua bashkë me të nxehtin Ahaz. Vam në krye-çytet të Filistinëve, na pritën me gaz e me mall, ftuan popullë të gjithë në një tempull të math tek ishin ngrehur madhështore statuja e Moloh-ut dhe të Dashurisë (kupidon). Nër mest të atyre dy statujavet ish një hedhër, andejaza do të flisnin. Bota gjithë ish mbledhur.

I pari desh të fliste Ahazi. U nis të hipenj maj hedhrës, po ç’goditi? Menj’ copëheresh qëndroj, një bujë dolli nga krahëror’ i statujës së Moloh-ut, që i ndehu dorën Ahaz-it dyke thënë “merr’ i këto”! Dorën Molohu e kish plot monedha të florinjta. Ahazi i habitur i merr, dheprapë u nis të hipenj maj hedhrës atëherë statuja e Dashurisë ngriti këmbën dhe trokiti maj truallit. Dy vjza me bukuri të hyejshme u hodhnë nga trualli dhe i dualle përpara Ahaz-it, e muer nëpelqi të dyja dhe e puthin cilado nga njëra faqe dyke thënë:

“Eja hipë të na flaç!” Po tani me çdo 135apë që bënte Ahaz-i që të hipenj, statujë e Moloh-ut i çpinte grushte florinj, dhe statuj’ e Dashurisë nga dy vajza më të bukura dhe më të puthura, më të ëmbla. Kur hipi lart shtiri sytë rrotull, iu muarë mëntë ish trullosur. Gjithë bota bërtisnin: “Eja thuajna!” “më së fundi do të nisnjë” thoshin ca të tjerë! Ahernaj Ahaz-i i pëqafoi gjith’ ato vajza dyke thënë: “S’kam gjëkafshë për të thënë! Jam Filistin!”(Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

* * *

Jam i vetmi, që kam kurajën të them, seç kanë frikë të thonë të tjerët

Pra, teoria e Rabinit është se nuk ka bindje pa forcën e detyrimit që duhet shfaqur para kundërshtarit, në këtë rast, të filistinëve.

* * *

Atë deshja të thosha dhe unë, se njerëzit do ta pandehnin të Vërtetën si Gënjeshtër dhe atje është goditja. Njeriu lint me të Vërtetë dhe vdes me të Vërtetë. Dyke qenë në jetët në mest të dy të Vërtetave të frikëshme misterit që e lint, dhe abissës që përpin, përpiket t'ia dëfrenjë shpasnë e mesme dhe rron dhe luan me gjëra të gënjeshtërmë.

TË GJITHË

Na vrave mëndjen! Mjaft! Zbrit andejza të të rrëfejme. Po pse s'flet si njeri, o i gJORë, të të marrim vesh?

RABINI

Dua t'u them se, në vent se të dërgojmë Samsonë vetëm me të Vërtetën, është më mirë të vemë dhe ne të gjithë bashkë me shpata. (Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

Në aktin e dytë Samsoni ndodhet në botën filistine. Mbreti kërkon nga Dalila që ta josh Samsonin me bukurinë e saj. Dalila ëndërronte se duke u bërë gruaja e tij, do ta mbante Samsonin në botën e tyre filistine, që i kërkohej edhe nga mbreti. Ky është akti i dashurisë dhe i mashtrimit të thurur nga Dalila. Asnjë fuqi filistine s'ia del dot ta mposhtë Samsonin. Harron misionin, dashurinë e parë që kishte për të dashurën e tij, të cilën e kishte lënë në atdhe, Rahilën. Samsoni, bukuroshes filistine ia zbulon sekretin e forcës së tij që e bënte gjithnjë të jetë i pathyeshëm para të tjerëve. Sekretin e fuqisë së tij ishin flokët e gjata që kishte. Një ditë, i dehur nga vera dhe dashuria, bie në duart e filistinëve. Ata ia shkurtojnë flokët dhe i humbet fuqia. Më pas e lidhin dhe e verbojnë, e thërret për ndihmë Rahilën, por ishte e kotë kjo gjë. Ai nuk mund të çlirohej nga dashuria që kishte për Dalilën e bukur filistine, me të cilën e ka lidhur fatin e tij përgjithmonë.

DALILE

(e puth, dhe thotë me vete) Gjemp' i parë!

SAMSON

Oh, moj Dalile, gjer tani s'desha të të puthnja, po një fuqi e pamundimshme më heq me ty, se të dua, sa e pa-lejesuar dhe e kriminelte është kjo dashuri për mua, aq më e fortë është pasioni.

DALILE

Gjëkafshë s'është mëkat kur vjen nga zëmëra.

SAMSON

Ah! Dalilkë! Përpara teje ndjenj të më mpakët fuqia, pandeh se dëbier udhën. Gjanj si zogu që fluturon pa pushim brenda në shkretëtirët dhe i lodhur nga udha e shumë zbret tek i pari oaz të pij ca pak ujë të kruat. (Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

Akti i tretë zhvillohet në tempullin e Baalit e të Malohut, të dy perëndive filistine: të pasurisë e të dashurisë. Njerëzit tallen me Samsonin të lidhure të verbuar.

Samsonit i vjen nga pak fuqia, thërret Dalilën dhe Rahilën dhe u kërkon të largohen nga tempulli që të shpëtojnë. Atëherë me fuqinë e rigjetur e rrëzon tempullin dhe vdes bashkë me filistinët që janë brenda. Duke qenë se është i vetëdijshëm se është bërë si ata, ai thërret:

SAMSON

(Thërret) Jam edhe unë si ata gënjeshtar. Filistin, shokë, bëjuni gati të vdesim qafë për qafë. (Noli F. S., Vepra 1, Albumi I, 1988)

Samsoni i Nolit sjell ide që shfaq imponim për të tjerët duke unreflektuar si e vërtetë reale. Madje kjo ide duhet të tregojë epërsinë e saj mbi kërkesat jetësore të kësaj bote.

Këtë ide e përçon tek të tjerët njeriu me veti jo të zakonshme njerëzore fizike e mendore, që nuk joshet nga argëtimi e pasuria. Nga dobësitë e tij të shfaqura, të cilat nuk i perfilli as gjatë këshillave të dalura nga përvojat e të tjerëve. Ai mundet nga dashuria dhe bukuria e femrës, mundet nga dobësitë njerëzore. Dashur pa dashur, ai bëhet një me kundërshtarët e tij.

Samsoni, jo vetëm që humbë fuqinë e mbinatyrshme që kishte dhe verbohet nga filistinët kundërshtarë të përbetuar që kishte, por e kërkon ta ketë të njejtin fat me të tjerët sepse nuk i bëri ballë një fuqie tjetër, siç ishte dashuria për Dalilën e bukur. Rikthimi i Samsonit në gjendjen e mëparshme është i pamundur dhe se më e rëndësishme është se ai tashmë bëhet i vetëdijshëm për gjendjen në të cilën ka arritur, për gjendjen të cilën vetë e krijoi dhe s'mund të dilte dot.

Në aktin e fundit, kur rrëzohet pallati i kundërshtarit, ai bën vetëvrasje dhe kërkon të mbeten gjallë dy dashuritë e tij: dashuria e parë ideale që kishte për Rahilën dhe dashuria reale që kishte për Dalilën.

Dalila personifikon edhe njërin ide edhe tjetër. Ajo kryen veprime atdhetare, njejtë si Samsoni në këtë rast, ndonëse këto veprime i kryen në nivelin e nevojave dhe dëshirave të saj për të plotësuar jetën e saj. Në të gjitha intrigat e saj, Dalila mendon në mënyrë naive se Samsonin do ta ketë për vete, do ta pushtojë idenë e tij me dashurinë e saj. Ajo e dashuron Samsonin si *burrë mbi burrat*, prandaj, nuk është e habitshme, kur i drejtohet se nuk mund ta dashurojë më, kur ai bëhet njeri i zakonshëm, kur humbë shikimin dhe fuqinë.

Fan Noli nuk e mbështet mendimin se një grua e bukur arrin ta mposht një burrë të pathyeshëm nga të tjerët. Noli mundohet të pasqyrojë të vërtetën reale me atë imagjinare. Nëse në fillim të dramës zotëron e para, madje argumentohet me forcë logjike, në zgjidhje fiton e dyta, pra e vërteta e jetës së gjallë.

4.2. Dramaciteti dhe përkimet në veprën *Israelitë dhe Filistinë*

Israelitë dhe Filistinë shfaqide të ndryshme të jetës së dy popujve, të dy popujve të personifikuar nga Samsoni nga njëra anë dhe Dalila nga ana tjetër. Tema bosht e dramës është se a mundën të jetojnë së bashku dy kultura të ndryshme, duke ruajtur veçoritë e tyre apo njëra duhet ta zotërojë tjetrën duke e asimiluar ngadalë. Pra është një dyluftim ndërmjet jetës dhe vdekjes. Se cila fiton Noli nuk na e thotë në dramë, mbetet enigmë.

Nëse drama e Nolit do të interpretohet nëpërmjet ideve shoqërore që kishte autori në rini, kur e shkroi këtë vepër e që më vonë u sprovua në shumë forma në jetën shqiptare, atëherë vepra do të marrë një ngjyrim edhe më tragjik. Noli edhe gjatë shqipërimit të dramave të autorët e ndryshëm bën lidhjen mes botës shqiptare dhe realitetit të kohës.

Mesazhin e kësaj drame më së miri lexuesi do ta gjejë në figurën e Samsonit, të Samsonit revolucionar apo të heroit të idealizuar që don t'i ndërrojë botërat, madje botërat e huaja. Ai nuk pranon idenë e Rabinit, i cili mendonte se vetëm me forcë duhet të nënshtroheshin kundërshtarët, gjë që doli të jetë e vërtetë. Samsoni vetë e kujton Rabinin në fund të jetës së tij, kur humbë i mposhtur nga e vërteta filistine.

Ndoshta vlera e kësaj drame të Nolit, që dramatizon idetë, qëndron te ajo që nuk këmbëngul vetëm në një ide, por shtron enigmën në formën e pyetjeve.

Kultura e tjetrit sado e fuqishme të jetë nuk duhet të paraqitet dominuese mbi kulturat tjera duke pasur për qëllim asimilimin. Pra, në raste të tilla provohet që kultura të imponohet me dhunë.

Noli nëpërmjet kësaj drame, gati njëjtë si te poezitë e tij, solli tema mjaftë interesante për të provuar lidhjen e ideve fillestare të tij dhe për të bërë dykuptimsinë intertekstore që është përmendur disa herë dhe është trajtuar në hollësi.

Me modele të tilla autori në letërsinë tonë solli një stil të ri, që nuk jemi mësuar ta shohim te shkrimtarët shqiptarë të periudhave të ndryshme kohore. Kjo jo rastësisht ndodh te Noli, sepse dihen ndikimet e mëdha që pati autori nga letërsitë dhe kulturat e popujve të tjerë, i cili tashmë i materializoi sa në dramën e tij të njohur dhe shumë të lexuar “*Israelitë dhe Filistinë*”, sa në veprat monumentale të tij të shkuara në prozë dhe poezitë e shumta që shkroi me temë biblike.

4.3. Frymëzimi real i Nolit në vepër

Noli, pasi veç kishte filluar të mirrej me aktivitete politike dhe punë patriotike, nuk kishte mundësi t'i përkushtohet krijimtarisë poetike. Edhe pse para Revolucionit të Qershorit ka mundur të shkruajë ndonjë pjesë nga krijimtaria e tij letrare, siç janë vjershat e tij të njohura “*Thomsoni dhe kuçedra*” (1914) dhe “*Jepni për Nënë*” (1917) Noli tregoi profilin e tij të vërtetë tek pas mbarimit të këtij revolucionit dhe se do t'i qaset krijimtarisë poetike në veçanti.

Në vjershën e parë, Noli ishte i dëshpëruar tej mase nga vrasja e kolonelit Thomson nga forcat e Esat Pashë Toptanit i cili donte ta rikthente në Shqipëri sundimin perandorak të Turqisë. Vjershën nuk do ta botojë menjëherë, por pas tri vitesh, kohë kur do të dalë edhe me botimin e

vjershës së tij të dytë “*Jepni për Nënë*” përmes së cilës poeti i bën thirrje bashkatdhetarëve tanë që jetojnë dhe veprojnë në Amerikë për ta ndihmuar atdheun e tyre pa kursyer.

Duket qartë se Noli deri në kohën e emigrimit të tij, nuk shkroi më shumë se disa vjersha të pakta, të cilat nuk shquhen për ndonjëvlerë të lartë letrare. *Ngado që shkonte, ngado që ndalonte dhe kurdo të ketë menduar për atdheun e tij të dashur, atij i është sjellur në kujtesë koha e revolucionit që e udhëhoqi me të gjitha pasojat që ka pasur për fatin historik të Shqipërisë.* (Zajmi, Fan Noli, jeta dhe vepra, 1986)

Vjershat më të mira të tij janë të frymëzuara nga këto ngjarje dhe shprehin meritë dhe simpatitë, me kujtimet dhe shpresat e tij politike. Në to autori qëroi hesapet me kundërshtarët e tij politikë dhe vetveten. Noli me vjershat e tij u bë lajmëtar i vetes së tij si prijës politik që ishte dhe u është përgjegjur kundërshtarëve të tij politikë.

Duke shkruar në moshën e pjekurisë së tij politike dhe krijuese, bëri bilancin politik të kohës së shkuar politike. Edhe me poezinë satirike që shkroi, Noli shpërfaqti realitetin e kohës më shumë se çdo shkrimtar i kohës. Me mllefën e tij ironik e satirik autori ka një afri të theksuar me Çajupin, i cili gjithashtu u është hakmarrë kundërshtarëve të tij personal me anë të shkrimeve poetike. Çajupi ka dobësitë intime të cilat i shfaqshpesh në veprat e tij, ndërsa te vepra e Nolit nuk hetohen fare, mund të thuhet se ai ishte shumë i përmbajtur dhe racional, sepse satirizoi dobësitë parimore morale të ideologjisë. *Noli poezitë e tij i shkroi kur Shqipëria kishte shpallur pavarësinë e saj, por akoma nuk ishte konsoliduar mirëfilli si shtet i qëndrueshëm politik dhe ekonomik, sepse shfrytëzohej në mënyrë të pandërgjegjshme nga klasa politike. Plagët nga pushtimi i egër pesëshekullor, si duket, tashmë reagonin sheshit.* (Zajmi, Fan Noli, jeta dhe vepra, 1986)

Me vargjet e veta Noli shfaq pakënaqësinë hapur me këto zhvillime në Shqipërinë e kohës së tij, të cilën e dëshoi krejt ndryshe, të përparuar ekonomikisht, politikisht dhe në aspektin kulturor.

Kundërshtarët e tij politikë, jo një herë, Noli i sulmoi nëpërmjet vjershave të tij poetike dhe në pamundësi që të mirrej me ta sa ishte në Shqipëri, gjatë kohës sa ishte aktiv në fushën e politikës, u mor në poezi pa i kursyer fare. Duke i bërë fajtorë për vuajtjet e popullit të tij, për urinë, mosdijen, prapambetjen, mjerimin e përgjithshëm moralisht, në gjithë poezinë e tij.

Kundërshtarët më të mëdhenj i ka mallkuar dhe futur në dhe, kurse kundërshtarët më të vegjël, të cilët nuk kishin pozita të rëndësishme në hierarkinë shtetërore i shpotiti në mënyrë më sipërfaqësore.

Noli me disa vjersha ka satirizuar drejtpërdrejt Ahmet Zogun dhe bashkëpunëtorët e tij, në numër të poezive të tij ka paraqitur veten dhe bashkëmendimtarët e vet. Kundërshtarët e tij i quajti me të drejtë *robërues shpirtërorë të popullit*, kurse veten dhe veprimtarët e tij i ka quajtur *çlirues*. Noli në poezinë e tij ka futur meritat e veta dhe i ka bërë vjershat e tij shpesh herë autobiografike. Kështu kuptohen dhe i kanë kuptuar vjershat e tij lexuesit dhe studiuesit.

Fan S. Noli nuk kërkoi frymëzime poetike duke lexuar burime të ndryshme në raftet librash dhe bibliotekash dhe arkivave historike, si disa prej vjershëtorëve tanë. Për këtë shkak Noli futi veten në vargjet poetike dhe i bëri personale. Poezinë ai e bëri një frymëzimi politik, por që u drejtohet dhe ju flet gjithë gjeneratave sepse poezitë e tij e plotësojnë shijen e lexuesit dhe gjithë pjesës intelektuale dhe estetike. Me trajtimin e ngjarjeve konkrete Noli ka arritur ta bëjë poezinë e tij interesante për gjithë ata që duan të njohin realitetin e Shqipërisë së kohës mes dy luftërash botërore, kurse me universalizmin e kuptimit të saj ai ka arritur ta bëjë interesante edhe për ata që kërkojnë kuptime dhe ndjenja të përhershme në to. Nën petkun e vjershave të realitetit politik, Noli fshehu ide që vazhdimisht i përsëritë historia. Në shumicën prej tyre përdori plot simbole të shpeshta letrare, shumica e të cilave janë simbole hebreje, kristiane e biblike.

Nga e gjithë kjo mund të konstatohet se Noli sikur është mbështetur nga botëkuptimi shekspirian se nuk është me rëndësi tema se sa trajtimi i saj dhe kuptimi që del prej saj. Ai mësoi nga poetët e mëdhenj dhe pjesën më të madhe të vjershave të tij e krijoi mbi këtë përvojë.

5. Dashuria si koncept universal në veprën e Nolit

Nolin të gjithë e njohim si një personalitet shumë i arrirë, serioz në trajtimet personale në vepër dhe se shumë pak e shohim të ketë paraqitje intime. Megjithatë nuk mund të themi se krijimtarinë e tij nuk e përshkon fare motivi erotik. Noli la në dorëshkrim poezi erotike të përfaqësuara me dy lirika intime, poezinë "*Plak topalldhe ashik*": dhe "*Sofokliu*" në të cilat përshkohet një humor i lehtë që karakterizohet nga përzierja ndjenjash gjallëruese dhe dëshira për ta jetuar jetën.

Protagonist i vjershës “*Plak topalldhe ashik*” nuk është djalë i ri, i bukur e plot hijeshi, por ashiku (dashnori) i cili jo vetëm që është plak, por edhe i çalë, që për t’i zënë hapin së dashurës, nxiton dhe djersitet shumë deri sa e arrinë për t’ia shfaqur dashurinë:

E arriva dhe ia thashë,
Asnjë gurë pa tundur s’lashë,
Dhe më gjunjazi i rashë,
Ç’u mundova kot.(Noli F. S., Albumi, 1968)

I lutet kot dhe i përgjërohet së dashurës plaku. Kot i bie në gjunjë që ajo ta mëshirojë dhe ta mirëkuptojë zemrën e tij, që po i digjej flakë. Për fat të keq e dashura ka qëlluar e ftohtë, zemër gurë dhe nuk i përfillë fare lutjet e tij, kështu që dashnorit i pikon në zemër, i dhimbset për vitet e shkuara, për rininë dhe e sheh me sy të përlotur realitetin e hidhur, pleqërinë:

Hapi gojën dhe vajtova,
Qenkam plakur, e kuptova
M’ardhi keq, po s’e mohova,
Syri m’u përlot.(Noli F. S., Albumi, 1968)

Ai që gjatë gjithë jetës së tij kishte qenë i shkujdesur, tani në pleqëri mërzhitet nga kjo jetë dhe në kulmin e dëshpërimit është gati të hidhet në lumë dhe të mbytet, por ja se zoti mëshirohet në pikëllimin e jetës së tij dhe ai pa kaluar shumë kohë, gjen një tjetër, e bashkë me të edhe kuptimin e jetës.

Edhe vjersha tjetër e Nolit *Sofokliu* është e ngjashme me të parën. E gjithë brendia e saj, sikurse e akuzon natyrën për padrejtësinë që bën ajo ndaj njerëzve të moshuar, të cilëve ua zvogëlon atyre aftësitë fizike, por nuk ua shuan edhe dëshirat dhe ëndërrat për t’i shijuar të mirat e kësaj bote, pra edhe dashurinë. Këtë e dëshmon edhe rasti i një plaku tetëdhjetë e pesë vjeç ashik, që nuse kërkoi kur vdiq.

Dashur pa dashur, këto poezi të kujtojnë “*Rubairat*” e Omar Khajamit dhe mbështetjen poetike që kishte Noli të arrihej qëllimi poetik. Për të treguar se edhe zemra e plakut di të dashurojë,

ndonëse nuk ka fuqi që ta arrijë vashën që e donte me zjarr, autori na kujton vargjet e vjershës së famshme “*Plaku*” të Çajupit.

Po kështu lypset përmendur se për hartimin e këtyre vjershave, veçanërisht të vjershës “*Plaktopall dhe ashik*”, Noli e ka shfrytëzuar edhe poezinë popullore, e në veçanti këngët e kësaj krijimtarië, këngët e dashurisë.

PËRFUNDIM

Trajtimi i temës së intertekstualitetit në veprën e Nolit ka një rol në pasurimin dhe ndriçimin më kuptimplotë në fushën studimore dhe të radhitjes pozitive të shkrimeve përmbajtësore për veprën e Nolit në kulturën shqiptare në tërësi.

Një gamë e gjerë e krijimtarisë së Nolit bëri që autorja e punimit të ndihej fare mirë për t'iu qasur me profesionalizëm dhe me kënaqësi kësaj teme, sa tërheqëse po aq të pasur dhe me interes edhe për lexuesin. Me qëllim të trajtimit sa më të mirë të kësaj teme masteri, në qendër të studimit ishte intertekstualiteti në veprat e Nolit, në poezi dhe në dramën e tij.

Në fund të veprës së tij “*Autobiografia*”, të botuar më 1958, Fan S. Noli e vlerëson punën e tij kulturore e kombëtare në mënyrë përmbledhëse, në kontributin e veprimtarisë kishtar-atdhetare, pavarësimin të Kishës Ortodokse shqiptare nga ajo greke; në diplomaci, ndihma dhe kontributi i tij në pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, më 1920; në fushën e veprimit kombëtar-politik--revolucionar, udhëheqja e Revolucionit Demokratik të Qershorit, më 1924; në fushën e publicistikës, drejtimi i disahershëm i gazetës Dielli e fletoreve letrare në Amerikë.

Gjithë ky opus i veprimtarisë së përgjithshme të Nolit është një tregues i mjaftueshëm për të trajtuar një temë mjaftë interesante në këtë punim masteri që, s’do mend, sjell një kënaqësi dhe privilegj të lartë, sepse trajtohet vepra e një poliedristi i cili u vlerësua gjithnjë nga studiues dhe kritikë në fushën e letrave shqipe, sa herë u kërkua dhe u bë temë trajtimi nga ta.

Krahasimet me ngjyrimet dhe mjeshtërinë artistike të Nolit duke nxjerrë paralele me ngjajshmëritë me shqetësimet kolektive shqiptare të kohës, janë në qendër të trajtimit për të hetuar më në detaje intertekstualitetin në veprat monumentale të këtij autori.

Kontributi i Fan Nolit lidhet fort me zhvillimet në kulturën tonë të shek. XX, sepse ai i shërbeu kësaj kulture me përkujdesin dhe përkushtimin më të lartë të mundshëm si poet, dramaturg, historian, biograf, publicist, orator e mbi të gjitha si shqipëruar i rrallë. Noli e pa Shqipërinë si një idealist dhe atë u përpoq praktikisht ta ndryshojë si politikan me një kontribut të pashoq dhe me përpjekje titanike. Noli ishte shkrimtar dhe veprimtar udhëheqës duke pasur ndikim të ndërsjellë tek njëra dhe veprimtaria tjetër e tij.

Fan S. Noli u rrit në frymën atdhetare, ndonëse fare pak jetoi në ambientin shqiptar. Kjo gjë reflektoi dukshëm edhe në gjithë veprimtarinë e tij krijuese. Ai gjithmonë do ta mbajë veten se kishte këtë prejardhje sepse edhe banorët e fshatit të tij nuk dinin gjuhë tjetër pos gjuhën shqipe.

Trajtimi i intertekstualitetit në veprimtarinë e Nolit mëton të japë shembuj konkret se paraqitja e tij nuk ishte e pamenduar, por ishte mjeshtërore dhe me shumë kuptim. Kjo gjë besoj se do t'u ndihmojë edhe lexuesve të ardhshëm që mirren me veprën e Nolit në mënyrë qëllimore. Interteksti jo një herë u shfaq te autorë të ndryshëm në letërsinë e përbotshme, çka jep për të kuptuar se Noli e gjeti të gatshme lëvrimin e kësaj teme dhe solli freski në kulturën shqiptare.

Me veprën e tij Noli ndikoi dukshëm në përforcimin e vetëdijes kombëtare duke trajtuar tema nga historia e kombit tonë dhe duke i freskuar ato vepra me burime bindëse për lexuesin. Disa herë, jo veç nga njohës të veprës së tij, është thënë se tek mjeshtëria e shfaqur në krijimet letrare të Nolit vërehet një përvojë e lartë. Jo rastësisht është konstatuar se vlerësuesi më i denjë i një veprë letrare është koha, andaj me të drejtë mund të konstatohet edhe këtu se ky vlerësim mund t'i dedikohet edhe krijimtarisë brilante të Fan S. Nolit.

Qasja studimore për të ndriçuar ide, qëllime dhe mjeshtëri të Nolit krijues, analiza e trajtimit të temave aktuale të shqetësimeve personale dhe kolektive të kohës mëtohet ta përmbush në plotëni sjelljen e ideve të avansuara të intelektualit të përmasave botërore. Shpalosja e trazimeve personale dhe kthimi mjeshtëror i tyre te kolektiviteti, që ka meritat dhe përgjegjësitë e krijimit meritohet të një shqetësimi djaloshtar dhe atdhetar tek autori. Kjo ide lëvrohet me fuqi të lartë poetike te poezia e tij të njohura me ngjyrimet personale dhe te drama e tij e vetme “*Israelitë dhe Filistinë*”.

I brumosur me kulturë të lartë dhe i ndikuar nga kulturat e ndryshme të antikitetit e këndeje, Noli nuk e pati të vështirë t'ua shtojë dykuptimësinë veprave të tij.

Fillimisht u vlerësua si më e udhës të trajtohet dykuptimësia në poezinë e Nolit gjatë punimit të kësaj teme masteri, për t'u ndalur pastaj te vepra “*Historia e Skënderbeut*”. Trajtimi dykuptimor u trajtua edhe në dramën e tij “*Israelitë dhe Filistinë*” duke sjellur në formë tekstore momentet kyçe të rolit të protagonistëve si referencë bindëse për lexuesin.

U la fare në fund të përmbylljes trajtimi i poezisë së pabotuar të Nolit, të poezisë lirike “*Plak topall dhe ashik*” dhe *Sofokliu*, për të rrumbullakësuar në mënyrë simbolike përfundimin e trajtimit të intertekstualitetit në gjithë krijimtarinë e Nolit, të botuar dhe të pabotuar deri më sot. Kjo për faktin sa për të dëshmuar se sa e gjerë dhe përmbajtësore është krijimtaria e tij.

Radhitja kronologjike e veprave të Nolit nuk ka mundur të bëhet me qëllimin e vetëm që të shkohet më shumë nga ana përmbajtësore e saj. Kjo për faktin se natyra e punimit të tillë nuk

durojnë një qasje të tillë, që do ta kishte dëmtuar dukshëm punimin dhe sigurisht do të kishte lënë zbrazëtira të theksuara, të cilat kanë qenë jashtë sferës së interesit të këti punimi.

Nuk mund të thuhet se nuk ka çka të shtohet dhe përpunohet akoma më shumë nga krijimtaria e Nolit sepse ajo është aq e thellë sa mbi të mund të bëhen studime të shumta për t'i hetuar edhe më tepër vlerat e saj monumentale që ka, andaj lehet mundësia e pranimit të vërejtjeve dhe sugjerimeve në vijim, të cilat veç çka do të jenë një nxitje dhe kurajo më këmbëngulëse e zgjerimit dhe pasurimit të këtij punimi masteri.

Sa herë që është shkruar për jetën dhe veprën e Fan Nolit nga historinët dhe studiuesit e letërsisë shqiptare apo nga kritikët e ndryshëm, një pjesë e madhe e tyre, kush më shumë e kush më pak, e kanë trajtuar ndikimin që pati Noli jo veç nga krijimtaria gojore, por edhe nga filozofët, politikanët reformistët etj. por që veprës u mundua t'i japë ngjyime origjinale me qëllimin e vetëm që të jetë e pëlqyer nga lexuesi.

Edhe në këtë punim masteri u mëtua të preken momentet kryesore të veprimtarisë së tij të cilat më së shumti u ndikua edhe lexuesi i saj në kohë të ndryshme. Me të drejtë Noli konsiderohet themelues i lirikës politike shqiptare, sepse si ai askush nuk shkroi kaq me ndikim. Noli bëri paralele tepër të trasha duke bërë një lidhje shumë të fortë në mes zhvillimeve politike sa në jetën reale pjesë e së cilës ishte personalisht, sa në botën letrare të cilat shfaq një mjeshtëri të lartë me të cilën mëton të jetë i pranueshëm nga të gjithë lexuesit shqiptarë. Vepra e tij, ndonëse ka ngjyime biblike, kurrë nuk mori epitete biblike, por u vlerësua mjeshtëria dhe risia ideo-artistike e paraqitur aty, mënyra etrajtimit të temave të tyre në nivel kaq të lartë.

Përmes kësaj poezie shoqërore e politike përshkohet fryma demokratike e autorit. Me të Noli goditi gjithë ato forca negative të shoqërisë shqiptare, duke mos u nënkuptuar se ai brengosej vetëm për humbjen e pushtetit politik që kishte. Noli merakosej më shumë për gjendjen e mjerueshme në të cilën ishte populli i tij. Noli deri në frymën e fundit luftoi për transformimin e jetës shqiptare, për përparimin e saj substancial, për të sjellë një mirëqenie të kuptueshme që do të shijohej nga të gjithë për të gjithë në çdo pjesë të jetës reale.

Nuk u dëgjua fare pak në jetën praktike, apo më mirë ta themi, nuk u kuptua drejtë duke u nënkuptuar se po impononte një ide, një praktikë që nuk i përkiste realitetit shqiptar. Kjo ndoshta në një masë mund të kuptohet si e tillë sepse gjendja në të cilën ndodhej populli shqiptar shumë vështirë do të ishte ta kuptonte ndryshimin. Pikëpamjet politike të Nolit tashmë dolën të bëhen realitet, ku një kohë të gjatë mbizotëroi ideja aspak racionale e demokratike.

Thënë thjeshtë, krijimet e Nolit janë krijime të përjetimeve momentesh të rëndësishme historike, duke trajtuar kohën e Revolucionit të Qershorit të vitit 1924. Kështu p.sh. vjersha “*Moisiu në mal*”, “*Marshi i Krishtit*”, “*Krishti me kamxhik*”, “*Shën Pjetri në mangall*”, “*Marshi i barabajt*”, “*Marshi i kryqësimit*”, “*Kirenari, Kryqësimi*” të trajtuara denjësisht gjatë gjithë kësaj teme masteri, ndonëse me ngarkesa të temave dhe simboleve biblike, lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me ngjarjet aktuale. Këto vjersha kanë vlera monumentale letrare. Autorin e tyre e kufizon alegoria biblike që të shprehet qartë dhe drejtë, pa paragjykime e rezerva. Përjashtim bëjnë vetëm dy vjershat e tij erotike të cilat u paraqitën me qëllim në këtë pjesë përmblylëse për të dëshmuar se Fan Noli ishte ndryshe, ishte njeri si gjithë të tjerët, porse e mbajti ndrydhur këtë fakt për të reflektuar më shumë në temat me interes publik të cilat dominuan në pjesën më të madhe të krijimtarisë poetike të tij.

Fan S. Noli arriti të krijojë vargje të një force të veçantë artistike shprehëse duke i pasuruar ato me figura të shumta stilistike. Mjetet më të preferuara të tij ishin epiteti, antiteza, alegoria, aliteracioni etj. por mbi të gjitha poeti shquhet për përdorimin e simboleve dhe përdorimin simbolik të ideve prandaj poezia e tij doli të jetë simbolike. Noli u ndikua fuqishëm nga letërsia izraelite si dhe nga letërsia greke dhe nga krijimtaria gojore shqiptare.

Noli ka një aftësi të rrallë në pikturimin e portreteve. Në vjershat e tij ai paraqet portrete të gjalla si përfaqësuesve të revolucionit ashtu edhe të reaksionit. Përgjithësisht virtytet ose veset e njerëzve, autori i nxjerrë në dukje përmes ndonjë veçorie të karakterit të tyre.

Noli në letërsinë shqipe solli një prozodi të veçantë dhe të pëlqyer nga lexuesi.

Në veprën tjetër të shkruar për Skënderbeun, Noli e idealizoi atë në forma mjeshtërore, duke sjellur para lexuesit risi të dorës së parë. Skënderbeun e kishte figurë frymëzuese të fëmijërisë, figurë që e stolisi me epitete trimërie, të figurës që solli vetëm unitet për popullin tonë. Ai ngritet në piedestalin më të lartë që duhej të reflektojë pozitivitet dhe të jetë shembull se si duhej sakrifikuar për lirinë e vendit. Epiteti i trimërisë i skalitur në mënyrë mjeshtërore edhe tek personazhet tjerë, që në fakt kishin tradhtuar Skënderbeun. Ata nuk ishin njerëz të thjeshtë, por prijës ushtarak shumë të shquar, roli i të cilëve ishte i pazëvendësueshëm në ushtrinë shqiptare.

Te drama monumentale, e para dhe e vetme e Nolit, ndonëse e shkruar në rininë e tij të hershme, ka ide të avancuara. Edhe në të dominon tema me motiv biblik, por përkimi i saj ka të bëjë me realitetin shqiptar të kohës.

Noli mbetet figura më poliedrike në kulturën shqiptare. Këtë e dëshmon me shumëllojshmërinë e shfaqur në veprën e tij, duke sjellur një freski të kënaqshme dhe duke e pasuruar në masë të madhe kulturën shqiptare. Kjo ndodhë edhe me faktin se preku tema të cilat do të hapin rrugë të trajtimeve letrare edhe nga shkrimtarët e rinj.

Me veprën e tij Noli ndikoi dukshëm në përforcimin e vetëdijes kombëtare duke trajtuar tema nga historia e kombit tonë dhe duke i freskuar ato vepra me burime bindëse për lexuesin. Disa herë, jo veç nga njohës të veprës së tij, është thënë se tek mjeshtëria e shfaqur në krijimet letrare të Nolit vërehet një përvojë e lartë.

Bibliografia

- Bala, V. (1988). *F.S. Noli - Poet, (Vështrim studimor)*. Prishtinë: Rilindja.
- Bala, V. (1988). *F.S. Noli - Poet, (Vështrim studimor)*. Prishtinë: Rilindja.
- Hamiti, S. (1999). *Letërsia moderne shqiptare*. Prishtinë.
- Hamiti, S. (1999). *Letërsia moderne shqiptare*. Prishtinë.
- Krasniqi, B. (1988). *Kode të ligjërimit letrar*. Prishtinë: Rilindja.
- Krasniqi, B. (1989). *Inteligjencia, letërsia dhe realiteti*. Prishtinë: Rilindja.
- Kristeva, J. (1960). *Semiotique editions de Seuil*. Paris.
- Noli, F. (1988). *Vepra 7*. Prishtinë: Rilindja.
- Noli, F. (1988). *Vepra 7*. Prishtinë: Rilindja.
- Noli, F. S. (1941). *Skënderbeu, Shkrimtarët shqiptarë II*. Tiranë.
- Noli, F. S. (1968). *Albumi*. Prishtinë: Rilindja.
- Noli, F. S. (1988). *Vepra 1, Albumi I*. Prishtinë: Rilindja.
- Noli, F. S. (1988). *Vepra 1, Albumi I*. Prishtinë: Rilindja.
- Noli, F. S. (1988). *Vepra 1, Albumi I*. Prishtinë: Rilindja.
- Noli, F. S. (1988). *Vepra 1, Albumi I*. Prishtinë: Rilindja.
- Noli, F. S. (1988). *Vepra 1, Albumi I*. Prishtinë: Rilindja.
- Noli, F. S. (1988). *Vepra 1, Albumi I*. Prishtinë: Rilindja.
- Noli, F. S. (1988). *Vepra 1, Albumi I*. Prishtinë: Rilindja.
- Noli, F. S. (1988). *Vepra 1, Albumi I*. Prishtinë: Rilindja.
- Noli, F. S. (1988). *Vepra 1, Albumi I*. Prishtinë: Rilindja.
- Noli, F. S. (1988). *Vepra 1, Albumi I*. Prishtinë: Rilindja.
- Noli, F. S. (1988). *Vepra 1, Albumi I*. Prishtinë: Rilindja.
- Noli, F. S. (1988). *Vepra 1, Albumi I*. Prishtinë: Rilindja.
- Noli, F. S. (1988). *Vepra 1, Albumi I*. Prishtinë: Rilindja.
- Noli, F. S. (1988). *Vepra 1, Albumi I*. Prishtinë: Rilindja.
- Noli, F. S. (1988). *Vepra 1, Albumi I*. Prishtinë: Rilindja.

Noli, F. S. (1988). *Vepra 1, Albumi I*. Prishtinë: Rilindja.

Noli, F. S. (1988). *Vepra 1, Albumi I*. Prishtinë: Rilindja.

Noli, F. S. (1988). *Vepra 1, Albumi I*. Prishtinë: Rilindja.

Noli, F. S. (1988). *Vepra 1, Albumi I*. Prishtinë: Rilindja.

Noli, F. S. (1988). *Vepra 1, Albumi I*. Prishtinë: Rilindja.

Noli, F. S. (1988). *Vepra 1, Albumi I*. Prishtinë: Rilindja.

Noli, F. S. (1988). *Vepra 1, Albumi I*. Prishtinë: Rilindja.

Noli, F. S. (1988). *Vepra 1, Albumi I*. Prishtinë: Rilindja.

Noli, F. S. (1988). *Vepra 1, Albumi I*. Prishtinë: Rilindja.

Piegay-Gros, N. (2011). *Hyrje në intertekstualitet*. Prishtinë: Parnas.

Piegay-Gros, N. (2011). *Hyrje në intertekstualitet*. Prishtinë: Parnas.

Piegay-Gros, N. (2011). *Hyrje në intertekstualitet*. Prishtinë: Parnas.

Piegay-Gros, N. (2011). *Hyrje në intertekstualitet*. Prishtinë: Parnas.

Piegay-Gros, N. (2011). *Hyrje në intertekstualitet*. Prishtinë: Parnas.

Piegay-Gros, N. (2011). *Hyrje në intertekstualitet*. Prishtinë: Parnas.

Shakespeare, U. (1981). *Hamleti*. Prishtinë: Rilindja.

Zajmi, Y. (1986). *Fan Noli, jeta dhe vepra*. Prishtinë: Rilindja.

Zajmi, Y. (1986). *Fan Noli, jeta dhe vepra*. Prishtinë: Rilindja.

Zajmi, Y. (1986). *Fan Noli, jeta dhe vepra*. Prishtinë: Rilindja.

Zajmi, Y. (1988). *Jeta dhe vepra e Fan Nolit*. Prishtinë: Rilindja.

L I T E R A T U R A

1. Aliu, Ali: Don Kishoti te shqiptarët. “Rilindja”, 1982, 5, 6 dhe 12 korrik.
2. Barleti, Marin: Histori e jetës dhe e veprave të Skënderbeut, Rilindja, Prishtinë, 1982, f. 506.
3. Buda, Aleks: Fan S. Noli historian i Skënderbeut. Në librin: Fan Stilian Noli, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, “Rilindja”, Prishtinë, 1968, f. 11-40.
4. Grup autorësh: Historia e Letërsisë Shqiptare, “Rilindja”, Prishtinë, 1989, f. 483-519.
5. Krasniqi, Dr. Bajram: “Kode të ligjërimit letrar” Rilindja, Prishtinë, 1988, f. 19-27.
6. Krasniqi, Bajram: “Inteligjencia, letërsia dhe realiteti” Rilindja, Prishtinë, 1989, f. 92-99.
7. Noli, Fan S.: Albumi, “Rilindja”, Prishtinë, 1968, f. 154. (Fan S. Noli, Vepra, vëllimi 1)
8. Noli, Fan S.: Ligjërime introdakta, “Rilindja”, Prishtinë, 1968, f. 139.
(Fan S. Noli, Vepra, vëllimi 2.)
9. Noli, Fan S.: Gjergj Kastrioti Skënderbeu (1405-1468). “Rilindja”, Prishtinë, 1968, f. 330
(Fan S. Noli, Vepra, vëllimi 4)
10. Noli, Fan S.: Israelitë dhe Filistinë. (Dramë me tre akte), “Rilindja”, Prishtinë, 1968, f.100
(Fan S. Noli, Vepra, vëllimi 5).
11. Noli, Fan S.: Autobiografia. (Përktheu Abdullah Karjakdiu), “Rilindja”, Prishtinë, 1968, 115
(Fan S. Noli, Vepra, vëllimi 6).
12. Noli, Fan S.: Historia e Skënderbeut, kryezotit të Arbërisë 1405-1468. “Enti i Botimit të Teksteve”, Beograd 1968 f. 133
13. Noli, Fan S.: Albumi II (Parathënien dhe biografinë kronologjike e shkroi Qerim M. Panariti) Boston, 1966, f. 118.
14. Noli, Fan S.: Rron or rron dhe nuk vdes shqiptari. (Pjesë të zgjedhura nga publicistika dhe letërkëmbimi). Mbledhur dhe paraqitur nga Piro Tako, “8 Nëntori”, Tiranë, 1978, f.392.
15. Noli, Fan S.: Vepra 1-7, “Rilindja”, Prishtinë, 1988, Vëllimi 1-7.

16. Piegay-Gros: Nathalye, “Hyrje në intertekstualitet”, Prishtinë, 2011
17. Qosja, Rexhep: Epizode letrare, “Rilindja”, Prishtinë, 1967, f. 21-42.
18. Qosja, Rexhep: Kritika letrare, “Rilindja”, Prishtinë, 1969, f. 7-55
19. Qosja, Rexhep: Shkrimtarë dhe periudha, botim i “Institutit Albanologjik” Prishtinë, 1975, f. 117-188.
20. Rugova, Ibrahim: “Kualitetet estetike të poezisë së Nolit”, “Jeta e re”, Prishtinë, 1975, nr. 3, f. 508-519.
21. Rrahmani, Zejnullah: Teoria e letërsisë, “Libri shkollor”, Prishtinë, 1999, f. 178.
22. Shuteriqi, Dhimitër: Studime historike, Tiranë, 1973, nr.3. f. 133-176.
23. Tako, Piro: Fan Noli, monografi, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1975, f. 295
24. Uçi, Alfred: Mitologjia, folklori, letërsia, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1982, f. 398
25. Uçi, Alfred, Problemet e estetikës, “Rilindja”, Prishtinë, 1980, f.274.
26. Vinca, Agim: Shkrirja e erudicionit me elokuencën, “Jeta e re”, nr. 3. Prishtinë, f. 499-508.
27. Zajmi, Yll, “Fan Noli, jeta dhe vepra” Rilindja, Prishtinë, 1986, f. 290.